



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Administrim  
Biznesi”**

**Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Artur RIBAJ**

**Prof. Asoc. Arba KRUJA**

**Tetor / 2022**

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master i Shkencave” në “Administrim Biznesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë  
Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 487 datë 18.10.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr.78, datë 13.05. 2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MAS Nr. 142 datë 25.03.2015.
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/1 PAK v.a 2020-2021 11 PAE/0 PAK v.a 2021-2022
18	Numri i studentëve:	17 Studentë v.a 2019-2020 7 Studentë v.a 2020-2021 6 Studentë v.a 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-



## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**



Programi i Studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është një program studimi i hapur në vitin 2012 nga Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Administrim Biznesit i KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" është hapur në vitin 2012 me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 487, datë 18/10/2012. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër të Këshillit të Akreditimit me VBA Nr. 90, datë 02.11.2015 si edhe Urdhër të MAS nr. 142 datë 25.03.2016.

Programi i studimit "Master i Shkencave në Administrim Biznesi", është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Programi ofrohet në gjuhën angleze dhe është i organizuar në module, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit, gjithsej 120 ECTS i ndarë në dy vite akademike dhe katër semestra.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (KU "IKT") i themeluar në vitin 2011, vjen me një eksperiencë mbi 10 vjeçare në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri. Edhe për këtë program studimi, objektivi kryesor i tij është të pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e administrim biznesit. Programi synon të formojë profesionistë të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të shoqërive dhe organizatave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Të regjistruar në vitin 2019-2020 ishin 17 studentë; në vitin 2020-2021 ishin 7 studentë dhe në vitin 2021-2022 ishin 6 studentë.

### **SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Akreditimi i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është realizuar për herë të parë, me Urdhër të MAS Nr. 142 datë 25.03.2016, mbi bazën e Vendimit Nr. 90, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë për një periudhë 6 vjeçare, **ku nuk është shoqëruar me rekomandime.**



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr. 109 ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues për akreditimin e programit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” me profile. Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Prof. Dr. Artur Ribaj;
2. Prof. As. Dr. Alba Kruja;

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ky dokumentacion pati disa mangësi të cilat u kërkuar të plotësohen nga ekspertët para se ata të shkonin për vizitë.

Ekspertët përgatitën draft vlerësimin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL në datat 31 Mars dhe 01 Prill, 2022. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutimeve intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrative, etj. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 07 Prill, 2022 përmes sistemit të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave dhe komenteve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi”. Në fund do të paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.10.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 89/32 Prot, datë 14.10.2022. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përcjell në ASCAL më datë 18.10.2022, me anë të shkresës me Nr. 437/2 Prot, datë 18.10.2022, njoftimin “Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Msc në Administrim Biznesi”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i “Shkencave në Administrim Biznesi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE.

#### Standardi I.1

**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që u bënë pjesë e DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion, ekspertët kontaktuan se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” i ofruar nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (KU “IKT”), nuk bien ndesh me interesat kombëtare, aspekt i cili evidentohet qartë në vizionin e institucionit si më poshtë: “Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i vendosur që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidërshtetit, të cilat ata do t’i përdorin për t’i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë.” (Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016”, neni 4, Vizioni; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 3. Plani Strategjik dhe Biznesi Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.))
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, I cili shprehet qartë në misionin e tij: “Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, ka si mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimin të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë.” (Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016”, neni 4, Misioni; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 3. Plani Strategjik dhe Biznesi Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me	Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të “Ekonomisë” (FE) dhe



<p>qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Departamentit të “Administrim Biznesit” ku ai bën pjesë. Si një program i ciklit të dytë, ai përgatit specialistë të aftë në fushat përkatëse të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, qoftë ky kontribut në rang specialisti ose në rang sipërmarrësi.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016”, neni 4, Misioni; Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit të Administrim Biznesit.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Mbështetur në dokumentat e paraqitura në DVV, ekspertët konstatojnë se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar duke përgatitur specialistë të aftë në fushat përkatëse të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, qoftë ky kontribut në rang specialisti ose në rang sipërmarrësi.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KU “IKT” për t’u profilizuar në programe të ciklit të parë dhe të dytë si dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme për ofrimin në të ardhmen të programeve të ciklit të tretë në fushën e Ekonomisë. Gjithashtu ky program i pajis studentët me aftësi profesionale dhe shkencore për të vazhduar me sukses studimet e ciklit të tretë në fushën e Ekonomisë.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.2**

**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV konstatoi se programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi është hartuar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të KU “IKT” (fq. 12-14 dhe 16-18), Statutin e tij (neni 2, pika 1 - a, b,c ) për ofrimin e programeve të studimit si dhe misionin dhe vizionin e tij (neni 4)</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016, neni 2 dhe 4; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017, fq. 12-14 dhe 16-18)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Referuar statutit të KU “IKT” (neni 4), fushat dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë përcakton qartë në pikat a, b, c, d, e, të misioni të institucionit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</li> <li>b) Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>c) Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</li> <li>d) Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.</li> <li>e) Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar aplikime dhe inovacione në fushat e kërkimeve të inxhinierisë dhe të ekonomisë.</li> </ul> <p>Këto pika referojnë fushat e ekonominë dhe inxhinierinë si fusha kryesore në të cilat KU “IKT” ka si objektiv të ofrojë programe mësimore/studimi si dhe të ndërtojë veprimtarinë e vet.</p> <p>Ekspertët gjithashtu konstatojnë se programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi është në përputhje me të gjitha aktet e tjera që burojnë si prej Statutit ashtu dhe Rregullores Institucionale.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 6. Rregullore Institucionale e KU IKT.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Referuar dokumentave strategjike të KU “IKT” si Statuti, Strategjitë e Zhvillimi, Rregullore, si dhe nga vizita në institucion, GVJ konkludon se: programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të institucionit.</p>

	<p>Emërtimi, organizimi, struktura si dhe përmbajtja e këtij program studimi është në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe objektivat e zhvillimit institucional, si dhe fushat e drejtimet akademike të tij.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 6. Rregullore Institucionale e KU IKT.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Ky program ka për qëllim përgatitjen e studentëve me njohuri dhe aftësi të mbështetura në një edukim të qëndrueshëm për të kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional në fushën e manaxhimit, në përputhje me kërkesat e tregut duke u konsultuar me institucione të rëndësishme, që janë ofruesit dhe aktorët më të rëndësishëm në tregun e punës.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 3. Plani Strategjik dhe Biznes Plani KU IKT, miratuar me VSA nr.5.1, 24.05.2012; Evidenca 6. Rregullore Institucionale e KU IKT.; Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011.; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3


**Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka të percaktuar qartë në rregulloren e tij objektiva lidhur me formimin e studentëve referuar dijeve, aftësive si dhe kompetencave profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të studimeve. Këto objektiva pasqyrohen në Rregulloren e Programit të Studimit, pika 3.3, faqe 6, “Objektivat e programit të Studimit”, si më poshtë:</p> <p>3.3.1 Programi i studimit Master i Shkencave synon të pajisë studentët me:</p>



<p>studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>a) Njohuri dhe koncepte bazë në fushat përkatëse të studimit dhe njohuri të thelluara të fushës kryesore të studimit;</li> <li>b) Aftësi për një profesion apo licencë profesionale;</li> <li>c) Formimi teorik dhe praktik në fushën e zgjedhur;</li> <li>d) Aftësi të zhvilluara për kërkim shkencor në fushën e studimit;</li> <li>e) Aftësi praktike, të zbatueshme dhe kërkimore;</li> <li>f) Aftësi për promovim personal dhe profesional;</li> <li>g) Tezë e punuar origjinale që tregon se si kuptohet puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse.</li> </ul> <p>3.3.2 Të diplomuarit nga ky program studimi përgatiten për karrierë/mundësi punësimi në çdo sektor të ekonomisë, biznesit privat dhe administratës publike.</p> <p>3.3.3 Të diplomuarit e këtij programi studimi duhet të kenë punuar/trajtuar listën e publikimeve të paraqitura individualisht në planprogramet e lëndëve të ofruara</p> <p>Ekspertët gjithashtu konstatojnë se ky program studimi është hapur në përputhje me Studimin e Tregut (Feasibility Study) të bërë në shkurt të vitit 2011.</p> <p><i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi.; Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>KU “IKT” ka kryer një studim mbi tregun lokal të përpara hapjes së programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Në këtë material KU “IKT” ka vlerësuar nevojat e tregut, mundësitë dhe synimet strategjike kombëtare, i cili trajton aspektet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një studim tregu;</li> <li>2. Një plan marketing;</li> <li>3. Një vlerësim të produktit;</li> <li>4. Një analizë financiare.</li> </ol> <p>Institucioni gjithashtu në shtator të vitit 2021 ka kryer një studim ku jep të dhëna si dhe bën një vlerësim lidhur me ecurinë e realizimit të objektivave të programeve të studimit të Fakultetit të Ekonomisë, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi, numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar si dhe performancën e tyre.</p> <p><i>(Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011.; Evidenca 19. Vlerësimi i programit të studimit në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit, fq. 56-99 dhe 99-118. Evidenca 75. Studimi periodik tregut MSc. Administrim Biznesi.)</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizitës në Institucion, GVJ konstaton se objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, si dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi.; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, sidomos në ato të Amerikës së Veriut, ato Kanadeze, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. Përveç krediteve të ofruara sipas sistemit evropian të krediteve ECTS, programi ofron edhe konvertimin e krediteve sipas atyre të Amerikës së Veriut. Në të njëjtën kohë edhe sistemi i vlerësimit të studentit bazohet mbi këtë eksperiencë.</p> <p><i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi.; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikave të mira të vendeve evropiane.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikave të mira ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ekspertët konstatojnë se programi i studimit “Master i shkencave” në “Administrim Biznesi” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. Praktika mësimore zhvillohet në vitin e dytë, gjatë semestrit të dytë dhe zgjat përkatësisht një semester, e cila shërben si një urë lidhëse ndërmjet dijeve të fituara prej studentëve me mundësinë për t’i aplikuar ato pranë sipërmarrjeve, bizneseve, kompanive të ndryshme.</p> <p><i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi.; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se i gjithë programi Master i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohet në gjuhën angleze. Kjo gjë ndihmon në mobilitetin e studentëve, stafit mësimor si dhe në përdorimin e një literature akademike mësimore ndërkombëtare.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se Institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### Standardi I.4

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 23 personel akademik efektivë (PAE) dhe asnjë me kontratë (PAK). Të tre njësitë pranë këtij fakulteti përmbushin kriteret e PAE si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit ka 8 anëtarë PAE, ndër të cilët 7 janë me gradë shkencore /titull akademik;</li> <li>- Departamenti i Administrim Biznesit ka 8 anëtarë PAE, ndër të cilët 7 janë me gradë shkencore /titull akademik;</li> <li>- Qendra për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim CIRD ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore/titull akademik.</li> </ul> <p><i>(Evidenca: Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3))</i></p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 11



<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore, që është Fakulteti i Ekonomisë, si dhe i shërben misionit të tij. Gjithashtu programi në fjalë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Administrim Biznesit dhe në shërbim të misionit të tij.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Evropiane dhe Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p><i>(Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit të Administrim Biznesit.; Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi.; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, KU "IKT" ka të përcaktuar në Statutin e tij si dhe në Rregulloren Institucionale, Librin e Rregulloreve Institucionale, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Rregulloren e Departamentit të Administrim Biznesit, Manualin e Stafit Akademik, etj, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive midis njësisë të ndryshme e personelit administrativ dhe akademik, nëpërmjet të cilave harmonizohet dhe strukturohet marrëdhënia institucionale, e cila saktëson qartë: Organet dhe strukturat drejtuese e menaxhuese institucionale; Strukturën drejtuese dhe ato mbështetëse në njësinë kryesore; Strukturën bashkëpunuese dhe që ndjek detyrat si dhe</p>

	<p>menaxhon njësinë bazë; Organet kolegjiale dhe ato vendimmarrëse në rang institucioni; Këshillat dhe komisionet; Etj.</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016. Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale.; Evidenca 6. Rregullore Institucionale e KU IKT.; Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit te Administrim Biznesit.; Evidenca 14. Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se Institucioni ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit. KU IKT ka krijuar marrëdhënie institucionale me universitete homologe, kompani, sipërmarrje, banka, organizata vendase dhe ndërkombëtare, të cilat fokusohen në memorandume apo bashkëpunime lidhur me realizime praktikash mësimore, shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe pedagogjike, realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare në mbështetje të studentëve, bashkëpunime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, ngritje kapacitetesh laboratorikë, etj.</p> <p><i>(Evidenca 25. Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022.; Dok 24. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022.; Evidenca 26. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.; Evidenca 67. Marreveshja CIT-Harvard 2014-2020.)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për të realizuar praktikat profesionale të studentëve, ndër të cilat vlen të përmenden marrëveshjet me IASTE Albania, Communication Progress sh.p.k, AKU Tiranë, IN2 sh.p.k, European Center of Sustainable Development (ECSD), AMF, Ditak shpk, Balfin Group, EasyPay shpk, IERA Academy, GjeoVjosa shpk, EXINN Technology Center, Shoqëria “Posta Shqiptare” sha, Procodev Security, Infosoftware System shpk/ Info Business Solution, Albtelecom sha, Credins Bank, Riga Technical University, GIZ, Deloitte Albania, UBA Bank, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në kuadër të programit CEEPUS dhe Erasmus+ si dhe aktorë të biznesit janë në mbështetje të realizimit të veprimtarive të përbashkëta kërkimore shkencore si dhe realizimit të praktikave profesionale. Gjatë vizitës në Institucion, ekspertët u njohën me Zyrën e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës (Students Affair &amp; Career Office), e cila ka si qëllim parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e</p>

	<p>praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë.</p> <p><i>(Evidenca 26. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se KU IKT ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të kërkimit shkencor si dhe universitete në kuadër të programit CEEPUS dhe Erasmus+ me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. Institucioni p.sh. ka marrëveshje të nënshkruara në kuadër të Erasmus+ për mobilitete akademike dhe studentore me Kassel University, Saarland University, etj.</p> <p><i>Ndërkohë që një pjesë e marrëveshjeve të nënshkruara nga KU IKT kanë përfunduar, ose janë në kuadër të ciklit të parë të studimeve, ekspertët sugjerojnë që institucioni të rinovojë këto marrëveshje apo t'i zgjerojë në mënyrë që të përfshijnë edhe ciklin e dytë, ose të shohë mundësi për marrëveshje të reja me institucione të tjera.</i></p> <p><i>(Evidenca 25. Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022.; Evidenca 24. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>KU IKT përgatit raport vjetor për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në të cilin përfshin informacione në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Por ky raport është i përgatitur në rang institucional dhe jo me fokus programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Megjithëse në RVB përmendet që Fakulteti gjithashtu harton raporte vjetore GVJ nuk gjeti evidenca të këtyre raporteve.</p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti i Administrim Biznesit të hartojë në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>(Evidenca 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi I.6**

**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 14



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>KU IKT mbështet publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik nëpërmjet Revistës Shkencore CIT Revieë, me ISSN dhe e indeksuar (<a href="https://crj.cit.edu.al/all-journals/">https://crj.cit.edu.al/all-journals/</a>); organizimit të konferencave shkencore dhe publikimit të materialeve në Proceedings (<a href="https://cit.edu.al/icdertt-2021-conference/">https://cit.edu.al/icdertt-2021-conference/</a>); mbështetjen e stafit akademik në pjesëmarrjen në konferenca. Vlen të përmendet që në Revistën CIT Revieë janë publikuar edhe artikuj shkencorë si rezultat i bashkëpunimit të stafit akademik me studentët. P.sh. në numrin nëntor 2021, të revistës rezultojnë dy publikime të përbashkëta. Gjithashtu KU IKT ka organizuar edhe konferenca studentore ku studentët e programit kanë marrë pjesë në to.</p> <p><i>Por ndërkohë ekspertët konstatojnë se nuk ka evidenca të publikimit të stafit akademik në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS apo Web of Science Clarivate Analytics. GVJ rekomandon që institucioni dhe njësia bazë të ndërmarrë një plan aksion për nxitjen, mbështjen dhe publikimin e kërkimit shkencor në revista prestigjioze ndërkombëtare jo vetëm të stafit akademik, por edhe të studentëve të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se KU IKT ka themeluar CIRD Ekonomi (Center for Innovation, Research and Development), e cila ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të qarta për kërkimin shkencor, inovacionin dhe kreativitetin si dhe në fund të vitit publikon raportin e vet mbi kërkimin shkencor në fakultet. <i>Por ndërkohë institucioni nuk ka dorëzuar evidence lidhur me vlerësimin e rezultateve që kjo njësi ka bërë ndër vite. Ekspertët rekomandojnë që njësia në fund të cdo viti akademik të bëjë një vlerësim të ecurisë së kërkimit shkencor të Departamentit të Administrim Biznesit lidhur me programin në fjalë.</i></p> <p><i>(Evidenca 5. Strategjia e RDC (Kërkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se KU "IKT" për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor ka hartuar në vitin 2014 "Strategjinë e RDC - Kërkimit, Zhvillimit dhe Krijimtarisë". Në kuadër të kësaj strategjie institucioni ka mbështetur (i) publikimin e artikujve shkencorë falas për stafin në revistën e vet shkencore CIT Revieë; (ii) mundësimin e pjesëmarrjes së stafit akademik pa pagesë në konferencat shkencore të organizuara prej tij ose në bashkëpunim me institucione homologe; (iii) sponsorizimin për stafin akademik për publikimin e artikujve shkencorë në revista me faktor impakti, ose pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare brenda e jashtë vendit.</p>



	<i>(Evidenca 5. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024; Evidenca D1. Praktika per financimin e kerkimit shkencor nga IAL; Evidenca D1.1 participation grant approval form; Evidenca D1.3 Rast aplikimi 1)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Referuar dokumentave të konsultuara, ekspertët konstatojnë se KU “IKT” ka hartuar “Kodin e Integritetit Akademik” si dhe “Kodin e Etikës” të cilët kanë në focus mbrojtjen e pronësisë intelektuale, por Institucioni nuk disponon një mekanizëm anti-plagjiaturë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale si në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve, apo në botimet e revistës institucionale CIT Revieë.  <i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se KU “IKT” u ofron studentëve mundësi botimi të punimeve shkencore në revistën institucionale CIT Revieë, si dhe në konferencat shkencore të organizuara në institucion. Në të njëjtën kohë institucioni ka organizuar ose ka bashkëpunuar në organizim me institucione të tjera homologe konferenca, seminare dhe hackathon-e studentore në të cilat kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm studentësh.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b> <b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje	Programi i studimit është organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (L. 80/2015 & VKM



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 16



<p>me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nr. 41 datë 24.01.2018). Ky program është organizuar me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar shpërndarjet në % për çdo kategori. (Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznes siguron një përgatitje të mjaftueshme që studentët të përshtaten në tregun e punës, në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. Ndër aftësitë që studentët fitojnë në përfundim të këtij programi studimi përfshihen: -zhvillimi i kompetencave manaxheriale në operacionet bazë të biznesit, si manaxhimi i operacioneve, marketing, financa, kontabiliteti, etj; -zhvillimi i aftësive statistikore të nevojshme për proceset vendimmarrëse; -kuptim në detaje i procesit të globalizimit dhe impakti i tij mbi vendimmarrjen manaxheriale; -zhvillimi i aftësive të leadershipit, por edhe i të punuarit në grup; -përmirësimi i aftësive komunikuese dhe prezantuese; -zhvillimi i aftësive kritike analitike dhe kërkimore.</p> <p>(Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe praktike në fushën e “Administrim Biznesit”. Ky program është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe bazuar në diskutimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij program dhe studentët, ekspertët konstatojnë se programi zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara fushën e “Administrim Biznesit”, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse si dhe u ofron studentëve një literaturë bashkëkohore.</p> <p>(Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi; Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011; Evidenca 56. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; Evidenca 75. Studimi periodik tregut MSc. Administrim Biznesi)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>(Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi; Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011; Evidenca 56. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; Evidenca 75. Studimi periodik tregut MSc. Administrim Biznesi)</p>





<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se ky program studimi është hartuar duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke u shprehur në planin mësimor dhe programet mësimore të lëndëve të këtij programi studimi. Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznes përmban elementët e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij. Programi është licensuar me 120 ECTS. Një kredit është 25 orë mësimore. Një vit akademik ka 60 ECTS, të cilat janë të barabarta me 1500 orë mësimore në total. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve. Të gjitha veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit si orët në auditor, ato jashtë auditori për studim individual, përgatitja për provime, përgatitja e tezës së diplomës etj., janë të përcaktuara sipas rregulloreve përkatëse dhe sipas planit mësimor.</p> <p><i>(Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” i ka lëndët të grupuara në lëndë të detyrueshme, karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Programi i studimit ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar modulet në përputhje me kategoritë e përcaktuara në VKM Nr. 41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.5) si edhe ngarkesën përkatëse në kredite për secilën kategori të veprimtarive formuese brenda këtij programi studimit duke respektuar peshën e përcaktuar në VKM Nr. 41 dt. 24/01/2018.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive, të organizuara në semestra përgjatë dy viteve, është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kategoria A: Lëndë bazë (përgatitja metodologjike dhe kultura e përgjithshme) – 5%;</li> <li>• Kategoria B: Lëndë karakterizuese (formim specifik) –55%;</li> <li>• Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore (nëndisiplina, profile grup-lëndë me zgjedhje) – 15%;</li> <li>• Kategoria D: Lëndë plotësuese (praktika profesionale) –10%;</li> <li>• Kategoria E: Detyrime përmbyllëse (përgatitja e tezës së diplomës) – 15%</li> </ul> <p><i>GVJ në të njëjtën kohë konstaton se, ky program nuk ka të alokuar një lëndë për përgatitjen metodologjike të studentëve, lëndë bazë e</i></p>


	<p><i>kategorisë A dhe e domosdoshme për studentë të masterit shkencor, por temat e së cilës janë të përfshira në një lëndë të kategorisë C “Communication Skills”. Ekspertët rekomandojnë që njësia bazë të bëjë rregullimet e duhura në kurrikul në mënyrë që njohuritë metodologjike t`u ofrohen studentëve nëpërmjet një lënde të alokuar në kategorinë A dhe të emërtuar përkatësisht.</i></p> <p><i>(Evidenca D10. Plani Mesimor per MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>KU IKT është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 781, datë 10.11.2011. KU IKT është akredituar institucionalisht, sipas VBA-ASCAL, Nr. 116, të datës, 15.12.2017 I vlefshëm deri më 14.12.2022. Programi i studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” është hapur me UMASR Nr. 487, datë 18.10.2012, akreditimi i parë i të cilit është marrë me Urdhër të MAS nr.142, datë 25.03.2016.</p> <p><i>(Evidenca: 1.2 Vendim per licensimin e KU IKT nr. 781, 10.11.2011; Evidenca 1.5 Certifikata e Akreditimit leshuar nga Bordi i Akreditimit 2017; Evidenca 1.4 Urdher nr. 487, 18.10.2012 per hapjen e programit te studimit; Evidenca 1.6 Akreditimi i pare i programit MSc MBA, Urdher i MAS nr.142, date 25.03.2016)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>KU IKT përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera të përcaktuara në statutin e tij sipas ligjit në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika 1). Gjithashtu, në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 22, pika</p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>2), Fakulteti i Ekonomisë është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit nën akreditim.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore e këtij programi, bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe ofron programe studimore në nivele të ndryshme (L. 80/2015, Neni 23, pika 1). Ky fakultet përbëhet nga 3 njësi bazë, funksionimi i të cilave përcaktohet në Statutin e KU IKT. Njësia kryesore/bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore (L. 80/2015 - Neni 25, pika 4), për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Referuar tabelës 3, kjo njësia kryesore përbëhet nga 3 Departamente, si më poshtë, në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë;</li> <li>2. Departamenti i Administrim Biznesit;</li> <li>3. Qendra për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim CIRD</li> </ol> <p>Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për programin Master Shkencor në Administrim Biznes, janë të përcaktuara në Statut, në Rregulloren institucionale si dhe në Rregulloren e Departamentit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë.</p> <p>Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit të Administrim Biznesit ka gradën shkencore, “Doktor”.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërje të tij për vitin akademik 2021-2022, 23 pedagogë, ku të gjithë (100%) janë Personel akademik efektiv (PAE).</p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit është njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, i cili ka 8 anëtarë PAE, ndër të cilët 7 janë me gradë shkencore /titull akademik (1 Prof. dr., 2 Prof. as., 4 Dr, 1 Msc); Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit ka 8 anëtarë PAE, ndër të cilët 7 janë me gradë shkencore /titull akademik; Qendra për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim CIRD ka 7 anëtarë PAE, ndër të cilët 3 janë me gradë shkencore/titull akademik. Të tre njësitë janë të organizuara në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 20, pika 2; Neni 22, pika 3; Neni 25, pika 1).</p> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 6. Rregullore Institucionale e KU IKT; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit të Administrim Biznesit; Evidenca: Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3); Evidenca Numri i personelit</i></p>




	<i>akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2))</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Referuar Tabelat 1 dhe 2 rezulton se Fakulteti i Ekonomisë nuk ka të punësuar Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA). Por ndërkohë gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se për realizimin e praktikave mësimore si dhe projekteve studimore e kërkimore, njësia kryesore dhe ajo bazë angazhojnë personelin akademik efektiv. <i>GVJ sugjeron që njësia të punësojë personel akademik ndihmës për stafi akademik lidhur me realizimin e praktikave mësimore dhe projekteve studimore e kërkimore, për të mundësuar një përdorim sa më efektiv dhe eficient të kapitalit human në institucion.</i>  <i>(Evidenca Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2))</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Referuar Vendimit e Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë si dhe takimeve gjatë vizitës në Institutin, ekspertët konstatojnë se Dr. Edmira Cakrani është koordinatorë për programin Master Shkencor në Administrim Biznesi. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura për programin e studimit dhe raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.  <i>(Evidenca 28. VSA Nr. 11, date. 15.10.2021)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin,	Departamenti i Administrim Biznesit është njësia bazë -kërkimore për organizimin e programit të studimit Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Ai disponon dokumentacionin e plotë për

strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit; Plani mësimor si edhe Syllabuset e lëndëve. Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018), Statutin e KU IKT (Aneks 1.01), si edhe Rregullores se Fakultetit.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Kurrikula përmban 17 lëndë të shpërndara në 4 semestra. Secila lëndë mësimore vlerësohet me numrin e krediteve përkatëse 6 ECTS, kurse Praktika ka 12 ECTS dhe Punimi i Diplomës 18 ECTS. Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b). Totali i krediteve plotëson numrin total të krediteve prej 120 ECTS.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Plani mësimor përfshin elementët e mëposhtëm në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018 (Pika 2.6): emërtimi për secilin modul të këtij programi studimi për çdo kurs, të grupuara dhe të renditura sipas semestrave përkatës; numri i krediteve për çdo modul; orët në total për secilin modul. Çdo modul ka detyrimet e tij (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli). Në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Sipas Planit mësimor ngarkesa totale vjetore për 120 ECTS është 3000 orë të shpërndara (Brenda dhe jashtë klase), 1500 orë në vitin e parë dhe 1500 orë në vitin e dytë. Prej këtyre orëve, 605 janë orë mësimore në vitin e parë dhe 605 janë orë mësimore në vitin e dytë. Në total studenti frekuenton 1210 orë në të dy vitet akademike të shpërndara në leksione, ushtrime, seminare, laborator, projekte, praktikë mësimore. Ndërkohë që 1790 orë janë orë jashtë auditorit.
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Vlerësimi akademik i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm. Planprogrami përcakton vlerësimin që ndjek çdo pedagog. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: Provime + detyra / projekte + pjesëmarrje aktive në procesin mësimor.  Provimet afatmesme dhe provimet përfundimtare zhvillohen në kohën e parashikuar në Kalendarin Akademik. Provimi i mesëm, si rregull, bëhet në javën e 7-të ose të 8-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare zhvillohen në fund të semestrit. Provimet zhvillohen me procedurë sekrete duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit deri në momentin e hapjes së tyre në sekretari, pasi profesori të ketë korrigjuar provimet.

	<p>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise; Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se programi i studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” përmban të gjithë informacionin e duhur për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Kriteret e pranimit që duhet të përmbushin studentët, janë të përcaktuara në Rregullon e këtij programi pika 2, ndërkohë kriteret për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve ndërmjet të të njëjtit cikël si brenda KU IKT apo nga institucione të tjera përcaktohen në Librin e Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VII, Transferimi dhe Kriteret e Pranimit si dhe Rregulloren e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi pika 9.</p> <p>(Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi; Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton ndryshimet që janë bërë krahasuar me planin mësimor të liçencuar në programin Master Shkencor në Administrim Biznes vijnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 lëndë e ndryshuar nga semestri i dytë (6 ECTS ndryshime);</li> <li>- 3 lëndë të ndryshuara nga semestri i tretë (18 ECTS ndryshime);</li> </ul> <p>Ndryshimi total në ECTS rezulton të jetë 20%, brenda kufirit të lejuar prej 20%.</p> <p>Këto ndryshime në përmbajtjen e programit të studimit janë reflektime të përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të programit përkundrejt nevojave të tregut. Njësia bazë është në kontakt të vazhdueshëm si me të diplomuarit e programit ashtu edhe me bizneset nëpërmjet organizimit të tryezave të rumbullakëta apo mbajtjes së leksioneve të hapura në auditor.</p> <p>(Evidenca: Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 11); Evidenca D2.2 Relacion per ndryshimet ne programin e studimit; Evidenca D2.3 Takim fokus-group me stutentet</p>



	<i>e Masterit Administrim Biznesi; Evidenca D2.4 Te dhena mbeshtetese analitike)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ referuar dokumentave të dorëzuar konstaton se ngarkesa e programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi ku program është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 120 ECTS;</li> <li>- 4 semestra, 2 në çdo vit;</li> <li>- Çdo semestër zgjat 15 javë mësim;</li> </ul> <p>Sipas Planit mësimor ngarkesa totale vjetore për 120 ECTS është 3000 orë të shpërndara (Brenda dhe jashtë klase), 1500 orë në vitin e parë dhe 1500 orë në vitin e dytë. Prej këtyre orëve, 605 janë orë mësimore në vitin e parë dhe 605 janë orë mësimore në vitin e dytë. Në total studenti frekuenton 1210 orë në të dy vitet akademike të shpërndara në leksione, ushtrime, seminare, laborator, projekte, praktikë mësimore. Ndërkohë që 1790 orë janë orë jashtë auditorit. Ngarkesa mësimore javore në auditor për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 20 orë secila.</p> <p><i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca D10. Plani Mesimor për MSc Administrim Biznesi sipas tabelës nr.10.)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- emërtimi i programit, përmbajtja e veprimtarive, dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe punësim të studentëve;</li> <li>- shpërndarja në vite e semestra e lëndëve/ moduleve, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e</p>	



objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor;
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare;</li> <li>- ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve;</li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<i>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi përmbajnë formatin dhe elementet përbërës të modelit sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. Gjatë takimeve me anëtarët e GVB-së dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, ekspertët konstatua se syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Ky është një proces i përvitshëm i cili nis që përpara se të fillojë viti akademik. Literatura elektronike që aksesohet prej stafit akademik të KU "IKT", është nga bashkëpunimi me McGraë-Hill Education dhe përfshin botimet më të fundit. Çdo student që ndjek studimet në një nga programet e institucionit, përfiton dhe aksesin në bibliotekën virtuale të McGraë-Hill Education. Ndërsa për një akses edhe më të madh në literature IKT ka marrëveshje me Kompaninë Distributor TEXO për shpërndarjen e teksteve në Shqipëri dhe në aksesin online të platformës O'REILLY.</p> <p><i>(Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 78. Marrëveshja CIT – TEXO; Evidenca 44. Te dhena mbi bibliotekën OREILLY-TEXO per CIT.)</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se programi Master Shkencor në "Administrim Biznesi" ka si fokus marrjen e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet për formimin e shprehive të veçanta në këtë fushë. Studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca të nevojshme lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve, funksionet e marketingut, financës, marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve.
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	

<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Zhvillimet e reja në tregje kanë bërë të nevojshme përshtatjen e kurrikulave mësimore me aftësitë që kërkon tregu i punës. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, institucioni ka zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktivitetesh konsultative, duke filluar që nga tryezat e rrumbullakta me bizneset, sipërmarrjet, me të ftuarit e ndryshëm dhe specialistë vendas e të huaj, etj. Në të njëjtën kohë njësia bazë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut. Ky program studimi i ciklit të dytë, nëpërmjet kombinimit të veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, synon të kujdeset që të pajisë studentët me njohuritë bazë të nevojshme profesionale dhe shkencore për të ndjekur trajnime të tjera të thelluara profesionale apo dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve.</p> <p><i>(Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011; Evidenca 56. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi)</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar të dhënave tabelare 6.1, 6.2, dhe 6.3, KU IKT përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me personelin akademik me kohë të plotë që angazhohet në realizimin e programit të studimit.</p> <p>Sipas listës së personelit akademik të programit të studimit, rezulton se të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2021-2022, janë 11 personel akademik efektiv (PAE) të cilët paraqiten me kualifikimin: 1 Prof. Dr.; 3 Prof. As., dhe 7 Dr.;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 26


<p>kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2020-2021, janë 10 personel akademik efektiv (PAE) të cilët paraqiten me kualifikimin: 2 Prof. Dr.; 4 Prof. As., dhe 4 Dr., si dhe 1 personel akademik me kontratë i cili mban kualifikimin Prof. As.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 2019-2020, janë 9 personel akademik efektiv (PAE) të cilët paraqiten me kualifikimin: 1 Prof. Dr.; 4 Prof. As., dhe 4 Dr.</li> </ul> <p>Referuar dokumentacionit të konsultuar më sipër si dhe CV-ve të stafit akademik dhe programit mësimor, GVJ konstaton se për të tre vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, programi i studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përmbush kërkesën ligjore që stafi akademik efektiv të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës mësimore, përkatesisht për vitin akademik 2021-2022 me 100% (VKM 418, Maj 2017).</li> <li>- përmbush kërkesën ligjore e të pasurit të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit;</li> <li>- niveli i kualifikimit, fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</li> </ul> <p><i>(Evidenca: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Master i Shkencor në Administrim Biznesi (Tabelat 6); Evidenca 21. CV e stafit akademik të programit të studimit MBA; Evidenca 22. CV e Stafit Akademik të Fakultetit Ekonomik)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomiksit dhe Administrimit ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas si dhe institucione publike në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Departamenti gjithashtu ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës.</p> <p><i>(Evidenca 26. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione të tjera 2016 – 2022; Evidenca D6. Listat e temave që kane zgjedhur studentet për të mbrojtur diplomën. MBA 2020-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se departamenti i IT të Institucionit mirëmban dhe përditëson kompjuterat me versionet më të fundit të paketave operuese, të nevojshme për realizimin e orëve laboratorike, në lëndët në të cilat janë parashikuar laboratorë.</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se departamenti i Administrim Biznesit me qëllim përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznes dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Për rrjedhojë në kryerjen e ndryshimeve në kurrikula apo në përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin në fjalë, institucioni ka zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktivitetesh konsultative, duke filluar që nga tryezat e rrumbullakta me bizneset, sipërmarrjet, me të ftuarit e ndryshëm dhe specialistë vendas e të huaj, etj. Pjesë e këtyre tryezave kanë qenë edhe studentët, ku janë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me dijet, aftësitë, kompetencat si dhe mundësitë që studentët e këtij programi përfitojnë gjatë dhe pas përfundimit të studimeve. Studentët kanë pasur mundësi të vlerësojnë njohuritë e marra në program, duke i krahasuar me njohuritë apo debatet dhe vlerësimet që kanë dhënë të ftuarit e ndryshëm. Në të njëjtën kohë njësia bazë ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut.</p> <p><i>(Evidenca 18. Studimi i Tregut (Feasibility Study) 2011; Evidenca 56. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; Evidenca 19. Vleresimi i prgramit te studimit ne perputhje me objektivat dhe Strategjine e Zhvillimit te Institucionit dhe Fakultetit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, duke ndjekur ecurinë e tyre, punësimin, arritjet, etj. Njësia kryesore mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre dhe organizon aktivitete të dedikuara për to si dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>



	<i>(Evidenca 77. Gjurmimi i studenteve te diplomuar nga IKT dhe NJSBC ne 5 vitet e fundit; Evidenca D2.1 Pyetesor me ALUMNI-t per programin e studimit dhe tregun e punes; Evidenca D2.2 Relacion per ndryshimet ne programin e studimit; Evidenca D2.3 Takim fokus-group me stutentet e Masterit Administrim Biznesi)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se si rezultat i studimit të tregut, konsultimeve si dhe bashkëbisedimeve me palë të treta, KU IKT ka hapur në vitin akademik 2021-2022 dy programe të reja: Master Shkencor në Marketing Dixhital dhe Master Shkencor në Teknologji Informacioni në Biznes.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vlerëson, nga shqyrtimi i dokumentave strategjikë të KU IKT, (Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit) dhe nga vizita në institucion, se programi i studimit Master Shkencor në “Administrim Biznesi” është në përputhje e në zbatim të planit strategjik dhe objektiveve madhorë të institucionit, në kuadër të strategjisë afatgjatë të zhvillimit të KU IKT, të tilla si: procesin e mësimdhënies/mësimnxënies, kërkimin shkencor, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, studentët, etj.  <i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca 2. Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017; Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit te Administrim Biznesit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Gjatë takimit me stafin akademik, por edhe nga shqyrtimi i dosjeve të tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka disa instrumenta nxitës të tillë si fondi i venë në dispozicion nga IAL për kërkimin shkencor, mundësi për publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në revistën shkencore CIT Revieë, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Autonomia dhe liria akademike janë të garantuara dhe ato bazohen në të drejtën ligjore si dhe në Statutin e KU IKT, në nenin nr. 2.


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 29



	<i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca D1.1 participation grant approval form)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Vlen të përmenden konferencat studentore të organizuara si dhe aktivitete të tjera si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Konferenca e III-të Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji», 07.05.2021 organizuar në bashkëpunim me Albanian University</li> <li>2. Konferencës studentore, “Sfidat e Biznesit në Epokën Digjitale”, më 09 qershor, 2021, organizuar në bashkëpunim me: IETT, Rrjeti Rinor IETT, Albanian University, Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.</li> <li>3. Hackathonit kombëtar “ViaEgnatia 2.0”, 27 nëntor 2020, organizuar në bashkëpunim me Aleancën Franceze dhe Ambasadën Franceze</li> <li>4. Konferencë mbi “Long-Life Digital Learning” – 5 tetor 2020</li> </ol> <p>Po ashtu në revistën shkencore të institucionit CIT Revieë, janë të publikuara edhe një sërë studimesh shkencore të punuara në bashkëpunim mes stafit akademik dhe studentëve.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	<p>Sic është evidentuar edhe në kritere të tjera më sipër, KU IKT ka vendosur marrëdhënie të ndryshme bashkëpunimi në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor të programit Master Shkencor në Administrim Biznes. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorë të biznesit janë në mbështetje të realizimit të veprimtarive të përbashkëta kërkimore shkencore rajonale dhe kombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 26. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 – 2022)</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	<p>Referuar dokumentacionit të konsultuar si dhe vizitës në institucion gjatë takimeve me stafin akademik si dhe drejtues të Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Projektet, GVJ konstaton se KU “IKT” mbështet njësinë kryesore dhe atë bazë për të zhvilluar kërkimin shkencor. Institucioni ka mbështetur stafin akademik të njësisë kryesore të Fakultetit të Ekonomisë në: Publikimet e tyre falas në revistën shkencore të institucionit; Pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit ose në bashkëpunim me insitucione të tjera; Sponsorizimin e artikujve shkencorë të publikuar në revista apo konferenca shkencore; Sponsorizimin e publikimit të literaturave</p>

	studimore, etj. Fakulteti i Ekonomisë dhe njësitë bazë, përmes grupeve të tyre shkencore kanë aplikuar për projekte dhe aktivitete të ndryshme bashkë me institucione të tjera universitare.  (Evidenca 5. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024; Evidenca D1. Praktika per financimin e kerkimit shkencor nga IAL; Evidenca D1.1 participation grant approval form; Evidenca D1.3 Rast aplikimi 1)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se në fillim të çdo viti akademik institucioni miraton grupet lëndore dhe ato të kërkimit shkencor, të cilat lidhen dhe me aplikimet për projekte. Referuar vendimit të Senatit Akademik nr. 7, datë 24.09.2021 grupet shkencore të ngritura me propozim të Fakultetit për vitin akademik 2021-2022 janë: 1. Grupi i Financë&Kontabilitetit/FinTech; 2. Grupi i Manaxhim&Marketing; 3. Grupi i Ekonomiks & Zhvillimi i Qëndrueshëm; 4. Grupi i Studimeve Sociale & Ambientale. Këto grupe bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me Njësinë e Kërkimit Shkencor CIRDA ashtu si dhe me Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Projektet dhe kanë aplikuar në projekte, sic edhe përmenden në raportin Vjetor të Institucionit për MAS (fq. 30-31).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Institucioni ka arritur të fitojë dy projekte: 1. "Inclusive Digital Education - a Tool to Understand Circular Economy" në kuadër të Erasmus + Call 2020 "Cooperation for innovation and the exchange of good practices- Partnerships for Digital Education Readiness". Kodi i Projektit: 2020-1-LV01-KA226-HE-094519; 2. "Integrating Digital Content and Digitalization of High Schools" Lloji: Cooperation partnerships in higher education Roli i IKT: Partner Kodi i Projektit: KA220-HED-A776F195  Ndërkohë KU IKT është ende në pritje të përgjigjes (short list) për aplikimin me projektin: Nanotechnology & Applications Education in
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	

Albania and Kosovo (NanoALKO). Lead partner, Helleinic Meditteranean University, Greece.

Për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor departamenti i Administrim Biznesit përveç stafit akademik angazhon edhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Përveç konferencave studentore ku studentët janë mbështetur prej stafit akademik, në të njëjtën kohë Departamenti ka marrë pjesë, por dhe ka organizuar projekte në të cilat studentë të ndryshëm janë angazhuar dhe kanë punuar mbi produkte reale dhe të ndryshme. Ndër projektet më të mëdha ka qenë projekti i fituar në vitin 2016 (me një kohëzgjatje dy vjeçare 2016-2018) prej Fondacionit CIRD të KU "IKT" "Mbështetja e Kërkimit Shkencor Cilësor në Shqipëri" (Suporting Quality Research in Albania), i sponsorizuar prej PERFORM, Helvetas Albania, Universite de Fribourg, Sëiss Agency for Development. Në shtator të vitit 2018, platforma kishte një frekuentim dhe një numër shumë të lartë përdoruesish: 300 kërkues shkencor; 18 akademik nga diaspora; 400 ekspertiza në fusha të ndryshme shkencore; 140 organizata të regjistruara; 15 fusha kërkimi aktive; 400 thirrje për projekte dhe bashkëpunime.

Departamenti ka marrë pjesë dhe ka organizuar edhe projekte të tjera ku studentë të ndryshëm janë angazhuar dhe kanë punuar mbi produkte reale dhe të ndryshme. Ndër këto vlen të përmenden: 1. Punimi dhe mirëmbajtja e Platformës "Skema e Pensioneve", 2016-2019, dhuruar Qeverisë Shqiptare. (<https://sot.com.al/politike/reforma-e-pensioneve-rama-ja-skema-e-p%C3%ABrlogaritjes-s%C3%AB-pensionit>) dhe 2. Punimi i Kalkulatorit të Pagave prej studentëve, 2021(<https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/>).

(Evidenca 27. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS, fq. 30-31; Evidenca 28. VSA Nr. 11, date. 15.10.2021; Evidenca 65. CIRD-CIT COORP Report 2016-2018.)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregullore të posaçme lidhur me përdorimin e metodave të mësimdhënies. Në Librin e Rregulloreve Institucionale në Kreun III, “Programi i Lëndës, Vlerësimi dhe Këshillimi i Studentit” gjenden katër rregullore të cilat standardizojnë në formë udhezimesh: (i) Strategjitë e mësimdhënies në institucion; (ii) Hartimin e programit të lëndës; (iii) Vlerësimin e studentit; dhe (iv) Procesin e Këshillimit.</p> <p>Rregullorja “Strategjitë e mësimdhënies në institucion” është zhvilluar pas një procesi të gjatë konsultimi me stafin dhe studentët dhe synon të jetë fleksibël për t’u përshtatur me ndryshimet dhe përfaqëson shtytjen kryesore për përmirësimin e cilësisë në edukim. Vlerat bazë mbi të cilat duhet të mbështetet puna e stafit akademik janë përshkruar në pikën 31 (fq. 44) të kësaj rregullorjeje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Një institucion i hapur akademik, i cili vlerëson lirinë e shprehjes si dhe respektin për të tjerët dhe nxit debatin.</li><li>- Një institucion akademik i angazhuar, që kërkon të përmirësojë jetën e njerëzve.</li><li>- Një institucion akademik krijues, që kërkon të frymëzojë ide pioniere dhe mënyra të reja të menduarit i cili shpesh i kapërcejnë kufijtë disiplinorë.</li><li>- Një institucion akademik ndërkombëtar, që kërkon të shqyrtojë çështjet në një kontekst global.</li><li>- Një hapësirë vitaliteti, diversiteti, entuziazmi dhe energjie, e cila ushqen dhe mbështet stafin dhe studentët.</li></ul> <p>Ndërkohë pstrategjitë e mësimdhënies parashikojnë që IKT të angazhohet për:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Të mbajë një profil të kufizuar të disiplinave dhe fushave akademike duke u fokusuar kryesisht në ekonomi dhe inxhinieri.</li><li>- Rritjen e marrëdhënies së ngushtë ndërmjet mësimdhënies, studimit, zhvillimit dhe kërkimit.</li><li>- Të zhvillojë tek studentët frymën etike edukative dhe profesionale, të menduarit kritik, aftësitë analitike dhe zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, inovacionin dhe lidërshpin.</li></ul>

	<p>- Ti sigurojë të diplomuarve konceptet bazë të të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p><i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik bëhet në mënyrë periodike nga departamenti i Administrim Biznesit dhe në rang Fakulteti. Si instrument përdoret pyetësori me studentët i cili realizohet para provimeve, rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore, në bashkërendim me NJSBC. Po ashtu KU IKT bën edhe një pyetësor drejtuar stafit për të matur kënaqësinë e stafit kundrejt institucionit, ndërkohë që po stafi bën edhe një vetëvlerësim lidhur me performancën në aktivitetet mvsimdhënëse dhe kërkimore në fund të vitit akademik. Të gjitha mekanizmat e monitorimit dhe të vlerësimit janë të përcaktuar në “Manualin e Sigurimit të Cilësisë” (CIT QAU Handbook, fq. 20-27).</p> <p>KU IKT për periudhën 2019-2021 ka bërë edhe vlerësimin e programit të studimit në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit.</p> <p>Në rang institucional, në funksion të sigurimit të cilësisë në KU “IKT” është ngritur një strukturë e qëndrueshme, e cila vepron në përputhje të plotë dhe me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, e cila njihet si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p> <p><i>(Evidenca 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook; Evidenca 29. Model Pyetësori Master në Administrim Biznesi; Evidenca 31. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 – 2021; Evidenca 19. Vlerësimi i prgramit të studimit në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit; Evidenca 30. Model Pyetësori per Stafin)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Ekspertët konstatojnë se KU IKT publikon në faqen e tij të internetit statistika dhe të dhëna mbi pyetësorët. Në rubrikën që i dedikohet NJSBC gjenden të publikuar të përmbledhura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatet e pyetësorit të vitit 2019 (<a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a>)</li> <li>• Rezultatet e pyetësorit të vitit 2020-2021 (<a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetsorit-2020-2021.pdf">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetsorit-2020-2021.pdf</a>)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se pasi NJSBC njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare të të dhënave të marra prej pyetësorëve.</p>

për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	<p>Bazuar mbi vlerësimet, kontributin si dhe ecurinë e proceseve akademike dhe administrative, institucioni ka vlerësuar për kontribute personalitete të ndryshme të stafit akademik si: Prof.Llukan Puka (<a href="https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/">https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/</a>).</p> <p>Ndërkohë në ceremoninë e 10-vjetorit të institucionit të organizuar gjatë muajit dhjetor 2021, janë vlerësuar për kontribute në vite edhe Prof.Dr. Shkelqim Cani, Prof.Assoc. Artur Jaupaj, Prof. Assoc.Fabian Zhilla etj. (<a href="https://cit.edu.al/cit-10th-anniversary-and-graduation-ceremony/">https://cit.edu.al/cit-10th-anniversary-and-graduation-ceremony/</a>).</p> <p><i>(Evidenca 50. Certifikata te dhena nga IKT)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive në KU IKT përfshijnë: leksione seminarat, ushtrimet, laboratorët, projektet, praktikatat profesionale. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijës sanksionohen në Rregullores për Programin e Lëndës, e cila ndodhet në Librin e Rregulloreve Institucionale, Kreu III, fq. 39.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivave formues. Në “Strategjitë e Mësimdhënies”, fq. 50 (Libri i Rregulloreve Institucionale) stafin akademik nxitet që të përqafojnë dhe mbështesin konceptet e reja që lidhen me teknikat pedagogjike dhe metodikën alternative të mësimdhënies. Lektorët prezantojnë dhe përdorin një shumëllojshmëri metodash dhe burimesh të mësimdhënies dhe të nxënit, si brenda dhe jashtë klasës, për të motivuar, sfiduar dhe përfshirë studentët, si: Të nxënit eksperimental; Teknika inteligjente të pyetjeve; Veprimtari praktike; Sesione interaktive në seminare të kombinuara me supervizim; Përdorimi i metodave të ndryshme ndërvepruese; Përdorimi teknikave Virtuale Mësimore; Udhëtime dhe vizita në terren; Ekspert të ftuar; Punë në grup e bazuar në
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 35

e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	raste studimore; Detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim. Këto format dhe metoda të mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Referuar planit mësimor për programin e studimit master shkencor në Administrim Biznesi, CV-ve të stafit akademik, Syllabuseve, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas lëndëve/modulit dhe tematikave të tyre. Gjithashtu KU IKT ka vënë në dispozicion të stafit akademik mjete bashkëkohore të mësimdhënies si ato audio-vizive, smartboard, laboratorë, etj.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nëpërmjet pyetësoreve drejtuar studentëve në fund të cdo semestri, Institucioni duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	<i>(Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca 21. CV e stafit akademik te programit te studimit MBA; Evidenca 29. Model Pyetesori Master ne Administrim Biznesi.pdf)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga njësia bazë si dhe inspektimit të ambjenteve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KU IKT ofron:  - Një sipërfaqe prej 2715 m <sup>2</sup> (dymijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë metra katrorë), të shpërndara në 2 kate me sipërfaqe sipas tabelës nr. 16/1 dhe 16/2.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për	



<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në shërbim të Fakultetit të Ekonomisë janë 2012 m<sup>2</sup>, prej të cilave në shërbim të procesit mësimor janë 854 m<sup>2</sup> (sipas tabelës nr. 16/1 dhe 16/2).</li> <li>- Hapësirat janë të mjaftueshme, me ndriçim dhe ajrosje dhe mirëmbahen e pastrohen nga stafi ndihmës i institucionit;</li> <li>- Janë funksionale dhe çdo sallë është e pajisur me videoprojektor, laptop dhe tabelë të bardhë apo smartboard;</li> <li>- Studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas,</li> <li>- KU “IKT” në funksion të shërbimeve ndaj studentëve, stafit por edhe palëve të treta ka në dispozicion sisteme të ndryshme informatike të cilat janë përmendur në tabelën nr. 17. Ndër këto sisteme mund të përmenden: E-learning; Google Meet/Classes; UMS (University Management System); McGraë-Hill Education; Check in/out system; CIT Go Digital; Koha; O’REILLY Platform.</li> <li>- Në dispozicion të institucionit është një personel i strukturës së teknologjisë së informacionit.</li> </ul> <p><i>(Evidenca Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16); Evidenca Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17))</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se Fakulteti i Ekonomisë vë në dispozicion të studentëve programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, i cili ofrohet në gjuhën angleze, një bibliotekë e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka virtuale në sajë të marrëveshjes me McGraë-Hill Education dhe O’Reilly. Biblioteka ka një fond të pasur me libra në fushat e Ekonomisë (sektorë të dedikuar për manaxhim, ekonomiks, financë, kontabilitet, marketing, etj) dhe shkencave sociale, të teknologjisë së informacionit, të shkencave të natyrës, apo humane. Biblioteka ka rreth 3000 tituj, me rreth 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2780 tituj në anglisht dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj, si frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Çdo student që ndjek studimet në një nga programet e institucionit, përfiton dhe aksesin në bibliotekën virtuale të McGraë-Hill Education dhe O’Reilly.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në faqen e internetit, seksioni i dedikuar bibliotekës (E-Resources) jep të dhëna dhe ndihmon studentët edhe me libraritë që ofrojnë falas tekste mësimore, që i ndihmojnë studentët jo vetëm të studiojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre, por dhe mund të shfrytëzohen pa limit për</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 37



	<p>projektet, detyrat e kursit si dhe temën e diplomës, siç janë ato të: • Edëard Elgar • DOAJ – Directory of Open Access Journals • SCIENCE COMMONS – Open access Laë Journal • BioOne Research Evolved • JSTOR • IOP Electronic Journals • Oxford Reference • OECD iLibrary • Directory of Open Access Books • The Neë England Journal of Medicine Oxford English Dictionary • YAKINDU.</p> <p><i>(Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 43. Te dhena mbeshtetese per blerjen e literatures ne biblioteken e IKT; Evidenca 44. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion ekspertët konstatuan se KU IKT ka vënë në dispozicion të programit Master Shkencor në Administrim Biznesi dy laboratorë informatike, të cilët shfrytëzohen nga studentët e programit për një pjesë të lëndëve duke përdorur programe specifike në varësi të lëndës. Gjithashtu në dispozicion të studentëve, janë vënë edhe ambientet e Bliotekës, e cila përdoret për punimin e detyrave të kursit, temës së diplomës apo studimeve specifike.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët konstatoi se studentët dhe pedagogët janë të pajisur me një adresë postare nga institucioni e cila mundëson komunikimin e shpejtë dhe efektiv pedagog-student dhe anasjelltas. KU “IKT” në funksion të mësimdhënies përdor platforma on-line (elearning) të tilla si: 1. E-learning (punuar prej stafit dhe studentëve); 2. Google Meet/Classes; 3. UMS (University Management System); 4. CIT Go Digital (punuar prej stafit dhe studentëve); 5. Platforma O’Reilly. Nëpërmjet përdorimit të platformave dixhitale, pedagogu i lëndës ka mundësinë të ngarkojë në sistem materialet mësimore si leksione, prezantime, detyra dhe komunikime të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët konstatoi se studentët orientohen, asistohen dhe mbështeteten nga pedagogu i tyre udhëheqës në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temave të diplomës. KU IKT ka hartuar gjithashtu Manualin e Diplomës, i cili i ndihmon në kriteret dhe teknikat për hartimin e tezës së diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17))</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion GVJ konstatoi se studentët orientohen, asistohen dhe mbështeteten nga pedagogu i tyre udhëheqës në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temave të diplomës. KU IKT ka hartuar gjithashtu Manualin e Diplomës, i cili i ndihmon në kriteret dhe teknikat për hartimin e tezës së diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca 13. Manual i Punimit te Tezes se Diplomes; Evidenca D6. Listat e temave qe kane zgjedhur studentet per te mbrojtur diplomen. MBA 2020-2022)</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Referuar Statutit të KU IKT, neni 9, pika m, Senati Akademik është organi përgjegjës që “vlerëson dhe garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion”.</p> <p>Ndërkohë në rang institucional për promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, institucioni ka ngritur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila garanton cilësinë e aktiviteteve akademike, aktiviteteve kulturore dhe sociale të stafit akademik dhe studentëve, si dhe aktivitetet administrative</li> <li>- Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, i cili është organi më i lartë që kontribuon në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.</li> </ul> <p><i>(Evidenca 1. Statuti i KU IKT 2016; Evidenca “Libri i Rregulloreve Institucionale”, Organizimi i NJSBC, fq. 26-27. “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”, fq. 28-32; Evidenca Libri i Rregulloreve Institucionale”, Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, fq. 33-35)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Referuar Rregulloreve të konsultuara si ajo e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullores së Departamentit të Administrim Biznesit, Librit të Rregulloreve Institucionale si dhe takimeve në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë, si njësi kryesore mban përgjegjësi për rritjen dhe vetëdijen e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në të gjitha programet që ajo ofron. Ndërkohë departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe ndjek proceset mësimore e kërkimore në bashkëveprim me stafin. Departamenti i Administrim Biznesit organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimin, kërkimin shkencor dhe</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	

	<p>angazhimin e studentëve në projekte, detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë.</p> <p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Baza për zhvillimin e procesit mësimor në KU IKT janë rregulloret: Strategjitë e Mësimdhënies në IKT; Plani Strategjik për Life-Long-Learning; Hartimi i Programit të Lëndës</p> <p><i>(Evidenca 8. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë; Evidenca 9. Rregullore e Departamentit të Administrimit Biznesit; Evidenca "Libri i Rregulloreve Institucionale", Strategjitë e Mësimdhënies në IKT, fq. 44. dhe Hartimi i Programit të Lëndës, fq. 39.; Evidenca 4. Miratimi i planit strategjik për LLL)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar takimit në institucion me stafin si dhe dokumentave të konsultuara, rezulton që KU IKT alokon buxhet për mbulimin e shpenzimeve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca si dhe botime të artikujve në revista shkencore. Institucioni gjithashtu mbështet pjesëmarrjen e stafit në projektet kërkimore dhe mobilitet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. <i>Por ndërkohë botimet në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science janë të pakta. Ekspertët rekomandojnë që institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin që të mund të botojë artikuj shkencorë edhe në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Eeb of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin të titujve akademike të stafit.</i></p> <p><i>(Evidenca 21. CV e stafit akademik të programit të studimit MBA)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>KU IKT ka zhvilluar trajnime të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësimdhënie si dhe përdorimin apo implementimin e metodave të reja pedagogjike, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Training on Google Meet (trajnim për platformën Google Meet), 21.10.2021 (<a href="https://cit.edu.al/google-meet-training/">https://cit.edu.al/google-meet-training/</a>)</li> <li>- Quality of Education: Outcomes based approach (Cilësia e edukimit: Qasja e bazuar në rezultate) datë 14.12.2016</li> <li>- Quality of Education: Preparation of examination (Cilësia e edukimit: Përgatitja e provimeve) datë 18.05.2016</li> <li>- Quality of Education: Hoë to evaluate students (Cilësia e edukimit: Si të vlerësojmë studentët) datë 31.03.2016</li> <li>- Google Suite Training Session (Trajnim mbi përdorimin e Google për të gjitha proceset mësimore) datë 07.02.2020</li> <li>- Ëorkshop on North American Educational System (Workshop mbi Sistemin e Edukimit Amerikano-Verior) datë 11.05.2018</li> </ul>





	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Training: I can change the world, datë 18.06.2019.</li> <li>- Professional training “Cloud Computing and Devops Training – Competitive Advantage and Faster Time to Market” datë 17.12.2020-23.12.2020 (<a href="https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/">https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/</a>)</li> <li>- Virtual Training Session on Econometrics datë 26 Maj 2021.</li> <li>- Training on latest updates of McGraë-Hill Education Company, datë 12.11.2020 (<a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraë-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraë-hill/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-ëith-mcgraë-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraë-hill/</a>)</li> <li>- Workshop: Gamification in Education, datë 07.10.2021 dhe 03.11.2021 (<a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-ëorkshop-highlights/">https://cit.edu.al/improve-innovation-ëith-gamification-ëorkshop-highlights/</a>)</li> <li>- Seminar: “Increasing the Visibility of Scientific Research and Ranking of the University”, date 07.05.2021 (<a href="https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/">https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/</a>)</li> <li>- Training on Teaching Pedagogy and Quality of Education datë 13.10.2021 (<a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/">https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/</a>)</li> <li>- Training on Curriculum and Course Development datë 17.01.2022</li> </ul> <p><i>(Evidenca 48. Certifikata trajnimesh dhe uorkshopesh dhene stafit te IKT)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara në institucion si me drejtuesit ashtu dhe me stafin GVJ konkludon se personeli akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Përgjegjësitë e stafit akademik janë gjithashtu të përcaktuara në kontratën e punës dhe në rregulloren e Departamentit të Administrim Biznesit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjithashtu personeli akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, por ndërkohë ekspertët nuk konstatojnë evidenca lidhur me analiza dhe raportime në mënyrë periodike në strukturat dhe njësitë përgjegjëse të efekteve dhe pritshmërive.</p> <p><i>(Evidenca 9. Rregullore e Departamentit të Administrim Biznesit; Evidenca 53. Kontrate tip Staf, Full-time 2021-2022; Evidenca 54. Kontrate tip Staf, Part -Time 2021-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, KU IKT ka angazhuar në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë</p>

programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke organizuar për studentët në mënyrë të herëpashershme seminare, leksione të hapura <sup>1</sup> , tryeza të rumbullakta <sup>2</sup> , trajnime <sup>3</sup> , etj.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Asnjë përbushje</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive, përcaktohen si në rregulloren “Mbi vlerësimin e studentit” që gjendet në Librin e Rregulloreve Institucionale (fq. 53-56), ashtu edhe në rregulloren e programit studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi neni 5. Kriteret dhe mënyra e testimit apo vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive janë publike dhe përmenden në Guidën e Studentit ( <a href="https://cit.edu.al/ëp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/ëp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a> ). Të gjitha këto element gjithashtu i bëhen të ditura studentëve dhe janë të publikuara në ëbsite individual të secilit prej pedagogëve të lëndëve në syllabuset e tyre në Portalin e KU IKT.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	

<sup>1</sup> <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/> ; <https://cit.edu.al/nurturing-entrepreneurial-mindset-as-a-key-competence-for-innovation/> ; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-webinar-with-special-guest-mr-joseph-oconnor/> ; <https://cit.edu.al/blockchain-technology-bitcoin-and-beyond/> ; <https://cit.edu.al/eu-exchange-coffee-talks/> ; <https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-open-lecture-with-dr-emir-dzanic/> ; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-open-lecture-with-prof-dr-arbnor-pajaziti/> ; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-open-lecture-with-phd-klodian-muco/> ; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-meeting-on-erasmus-and-cits-inter-institutional-agreements-with-european-partner-institutions/> ; <https://cit.edu.al/open-lecture-with-erdogan-imeri-on-the-topic-of-how-digital-transformation-is-revolutionizing-the-healthcare-industry/> ; <https://cit.edu.al/management-of-information-systems-and-mcgraw-hill-literature/> ; <https://cit.edu.al/online-open-lecture/> ; <https://cit.edu.al/european-digital-week/>

<sup>2</sup> <https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/> ; <https://cit.edu.al/cit-debate-fiscal-package-for-2022s-budget/> ; <https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-global-entrepreneurship-week/> ; <https://cit.edu.al/cit-experience-from-finland-to-cit-in-tirana/> ; <https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/>

<sup>3</sup> <https://cit.edu.al/cit-participated-in-a-workshop-held-by-rcdc-albania/> ; <https://cit.edu.al/u-report-albania/> ; <https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni/> ; <https://cit.edu.al/one-month-internship-in-web-programming/>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42




<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e njohurive, të përcaktuara në seksionin III.II të rregullores mbi vlerësimin e studentëve, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Provimi i mesëm (Midterm Exam)</li> <li>2. Provimi përfundimtar (Final Exam)</li> <li>3. Riprovime (Re-examination)</li> <li>4. Përmirësimi (Improvement)</li> <li>5. Mbrojtja e tezës për diplomim (Diploma thesis defence)</li> </ol> <p>Si rregull, provimi mund të përbëhet nga 3 kategori pyetjesh të cilat mund të ndryshojnë në varësi të lëndëve dhe moduleve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pyetje që kontrollojnë njohuritë, 20-30% e provimit;</li> <li>2. Pyetje për të testuar aftësitë analitike, 40-50% e provimit;</li> <li>3. Pyetje që kërkojnë mendim dhe pohim individual të studentit (në formën e analizave kritike, raste studimore, ose ushtrime), 20-30% e provimit</li> </ol> <p>Ndërkohë pesha që duhet të zënë komponentet e vlerësimin, referuar Rregullores “Mbi vlerësimin e studentit”, Libri i rregulloreve Institucionale, fq. 55, është e shpërndarë në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja 10%</li> <li>- Detyrat e kursit 40%</li> <li>- Testime (të ndërmjetme, projekte etj) 20%</li> <li>- Provimi përfundimtar 30%</li> </ul> <p>Në respektim të lirisë akademike, mes këtyre kategorive ka një marzh lëvizjeje prej 10-20%.</p> <p><i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b></p>	
<p><b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë</p>	<p>GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, rregulloreve e stafit akademik konkludon se elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, punimet/projektet dhe niveli i aktivizimit në seminare apo</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 43

<p>vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>punë laboratorike, provime të ndërmjetme, vlerësime në bazë të pyetje-përgjigjeve, etj. Referuar Rregullore “Mbi vlerësimin e studentit”, Libri i rregulloreve Institucionale, fq. 55, vlerësimi I studentëve është i shpërndarë në forma dhe mënyra të ndryshme duke u realizuar gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja 10%</li> <li>- Detyrat e kursit 40%</li> <li>- Testime (të ndërmjetme, projekte etj) 20%</li> <li>- Provimi përfundimtar 30%</li> </ul> <p>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se KU IKT nuk përdor sisteme elektronik të testimit dhe vlerësimit me fokus eliminimin e formave të ndryshme të abuzimit dhe rritje të transparencës, pasi numri i studentëve është i vogël dhe i manaxhueshëm. Në të ardhmen, me rritjen e numrit të studentëve, institucioni do gjykojë nëse do të jetë efektive apo jo përdorimi i sistemeve të vlerësimit elektronik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion si dhe Rregullore të Programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, pika 7 “Praktika” dhe pika 8 “Diplomimi”, GVJ konstaton se praktika profesionale dhe diplomimi realizohen nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.</p> <p>(Evidenca 10. Rregullore e Programit të Studimit MSc. në Administrim Biznesi)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Referuar takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion si dhe “Rregullore të Sekretarisë Mësimore – Cikli i Dytë”, pikat 5.3.2 dhe 5.3.3, fq. 5. GVJ konstaton se:</p> <p>5.3.2 Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p> <p>5.3.3 Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Brenda këtyre dy javëve, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p>

	<p>I gjithë ambienti në institucion është i pajisur me kamera sigurie.</p> <p><i>(Evidenca 12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i dyte 2021-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Në Librin e Rregulloreve Institucionale, “Mbi Vlerësimin e Studentit”, fq. 53, pika III.I.2 theksohet se: “Vlerësimi i studentëve është stimulues, jo penalizues. Për këtë qëllim, çdo vlerësim duhet të jetë i shoqëruar me komentet e duhur”.</p> <p><i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se KU IKT ndjek politika lidhur me kopjimin, plagjiaturën dhe çdo element tjetër që shtrembëron vlerësimin e studentit duke u bazuar në Librin e Rregulloreve Institucionale, përkatësisht në “Kodin e Integritetit Akademik” dhe “Kodin e Etikës”. Po ashtu studenti informohet për këto rregulla edhe nëpërmjet “Guidës së Studentit” (<a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a>) dhe në “Programin e Lëndës”.</p> <p>Gjithashtu në “Manualit e Punimit të Diplomës”, studentëve u sqarohet referimi, citimi sipas APA, por ndërkohë GVJ konstaton se KU IKT nuk disponon një mekanizëm Anti-plagjiaturë për të evituar plagjiaturën dhe mbrojtur pronësisë intelektuale si në detyrat e kursit dhe punimet e tezës së diplomimit të studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale, Kodi i Integritetit Akademik, fq.7-8 dhe Kodi i Etikës, fq. 9; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022; Evidenca 13. Manual i Punimit te Tezes se Diplomes)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik, studentët dhe zyrat përkatëse, GVJ konstaton se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentit dhe jepen në kohë duke qenë se ato diskutohen mes pedagogut dhe studentit. Gjithashtu rezultatet hidhen edhe në UMS (Univeristy Mangement System), ku studenti mund të ndjekë dhe të ketë të gjitha vlerësimet sipas komponentëve përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (testim, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, referuar Rregullores se Sekretarisë Mësimore, pika 5.6. fq. 6, studenti mund t’i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al




Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 45

<p>Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit me pas, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p> <p>Nëse studenti nuk është i kënaqur me zgjidhjen e ofruar nga komisioni, studenti brenda 15 ditësh nga dhënia e vendimit mund t'i drejtohet zv. Rektorit me synim "Kërkesën për t'u dëgjuar" nga ky i fundit në një takim të posaçëm. Zv. Rektori duhet t'i ktheje përgjigje studentit brenda pesë ditësh në lidhje me apelin për t'u dëgjuar. Pas kësaj zv. Rektori mund të ngrejë një komision përmes të cilit mund t'i japë studentit mundësinë për t'u dëgjuar. Vendimi për pranimin e apelit dhe caktimin e datës së dëgjimit shpallet nga zv. Rektori dhe njoftohet studentit brenda që brenda 20 ditëve të paraqitet për "seancën dëgjimore". Brenda këtij afati studenti duhet të paraqitet dhe të parashtrijë apelin e tij ndaj çështjes përpara komisionit. Vendimi i Komisionit është përfundimtar. E drejta e studentit për të apeluar për vlerësimin sqarohet edhe në Guidën e Studentit pika 1.2. (<a href="https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/ep-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a>)</p> <p><i>(Evidenca 12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i dyte 2021-2022)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b></p>	
<p><b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë sipas udhëzimit 41, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të menaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit. Në program përfshihen lënëdë të tilla si: Stategic Analysis, Managerial Finance, Marketing Management, Planning and Control Systems, Advanced Project Management, etj. Këto lëndë, së bashku me të tjerat në programin e studimit zhvillojnë aftësitë profesionale dhe të vecanta të studentëve që ndjekin këtë program studimi, duke qenë se këto njohuri i përkasin studimeve të ciklit të dytë.</p>

	<i>(Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në zbatim të VKM 41, datë 24.1.2018, GVJ konstatoi se modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblyëse. Programi oftohet në gjuhën angleze dhe u mundëson studentëve për të rritur nivelin e aftësive të tyre në fushën e teknologjisë së informacionit, në atë të komunikimit, nëpërmjet lëndëve të tilla si: Computer-Aided Decision Making, Communication Skills, Interpersonal Relationship and Leadership, etj.  <i>(Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Referuar rregullores “Strategjitë e Mësimdhënies” në Librin e Rregulloreve Institucionale (fq.46) si dhe takimeve të zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, janë të përcaktuara në këtë rregullore dhe stafi akademik i përshtat këto kompetenca në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, si dhe i analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Ndërkohë java e fundit e programit të lëndës është paraparë që të jetë javë përsëritëse, në mënyrë që të ndihmohen studentët për të rishqyrtuar edhe njëherë me pedagogun e lëndës të gjitha njohuritë dhe konceptet e marra gjatë semestrit.  <i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Sic është evidentuar edhe më sipër KU IKT ka organizuar një sërë trajnimesh, seminaresh, konferencash studentore, leksione të hapura me të ftuar të ndryshëm dhe tryeza të rrumbullakta, me synim aftësimin e studentëve, për t’u përfshirë sa më shumë në tregun e punës dhe për t’u njohur me aftësitë dhe kompetencat që ky treg kërkon <sup>4</sup> .

<sup>4</sup> <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-and-business-cooperations/>; <https://cit.edu.al/nurturing-entrepreneurial-mindset-as-a-key-competence-for-innovation/>; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-webinar-with-special-guest-mr-joseph-oconnor/>; <https://cit.edu.al/blockchain-technology-bitcoin-and-beyond/>; <https://cit.edu.al/eu-exchange-coffee-talks/>; <https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-open-lecture-with-dr-emir-dzanic/>; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-open-lecture-with-prof-dr-arbnor-pajaziti/>; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-open-lecture-with-phd-klodian-muco/>; <https://cit.edu.al/highlights-of-the-virtual-meeting-on-erasmus-and-cits-inter-institutional-agreements-with-european-partner-institutions/>; <https://cit.edu.al/open-lecture-with-erdogan-imeri-on-the-topic-of-how-digital-transformation-is-revolutionizing-the-healthcare-industry/>; <https://cit.edu.al/management-of-information-systems-and-mcgraw-hill-literature/>; <https://cit.edu.al/online-open-lecture/>; <https://cit.edu.al/european-digital-week/>; <https://cit.edu.al/round-table-discussion-with-credins-bank/>; <https://cit.edu.al/cit-debate-fiscal-package-for-2022s-budget/>; <https://cit.edu.al/cit-participated-in-the-global-entrepreneurship-week/>; <https://cit.edu.al/cit->

<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentët me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo u jep mundësi studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p><i>(Evidenca 16. Plani mesimor i programit MBA 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p><i>(Evidenca 20. Programet e lendeve MSc Admin Bizn. 2021-2022)</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Sic është evidentuar edhe më sipër si institucioni ashtu edhe personeli akademik kanë krijuar klimën dhe infrastrukturën e nevojshme të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe ka mbështetur aktivitete të tilla si organizimi i Konferencave Studentore apo zhvillimin e disa ideve inovative e teknologjike në dobi të institucionit, shoqërisë ose palëve të treta.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>				
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se institucioni ka nënshkruar marrëveshje për periudhën 2014-2020 me Harvard Business School, nga ku ka përdorur setin e dokumenteve të mësimdhënies për disa lëndë. Nga ana tjetër IKT ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në kuadër të Erasmus+ dhe është anëtarësuar në CEEPUS, duke bërë të mundur që këto institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë të njohin mobilitetin studentor me institucionin dhe programet e ofruara prej tij.</p> <p><i>(Evidenca 67. Marrëveshja CIT-Harvard 2014-2020;</i></p>			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

experience-from-finland-to-cit-in-tirana/; <https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/>  
<https://cit.edu.al/cit-participated-in-a-workshop-held-by-rcdc-albania/>; <https://cit.edu.al/u-report-albania/>;  
<https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni/>; <https://cit.edu.al/one-month-internship-in-web-programming/>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 48





Shkalla e përmbushjes së standardit

X

### Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

**Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

**Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.

**Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

**Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.

GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV si dhe gjatë vizitës në Institucion konstatoi se KU IKT u ofron studentëve vetëm mundësinë e diplomimit me Tezë Diplome dhe jo me Provim Final. Për mbrojtjen e diplomës institucioni ka hartuar rregullore, manualë dhe procedura të posaçme, si: Mbi punimin e diplomës – Libri i Rregulloreve Institucionale, fq. 62-73; Manuali i Punimit të Diplomës dhe Rregullorja e Programit të Studimit dhe Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, Cikli i Dytë. Rregullorja dhe Manuali i Diplomës, i cili i ndihmon në kriteret dhe teknikat për hartimin e tezës së diplomimit, u shpërndahet studentëve nga Sekretaria Mësimore.

Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit dhe në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.

Pika 8 e Rregullores së Programit të Studimit I referohet Diplomimit të studentit dhe qartëson hapat që duhet të ndjekë student si më poshtë:

- 8.1 Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi.
- 8.2 Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat e takimit me studentët.
- 8.3 Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë.
- 8.4 Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.
- 8.5 Në çdo rast, studentin nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa shlyer të gjitha detyrimet e tjera të programit të studimit.
- 8.6 Kalendari akademik parashikon 2 (dy) sezona të rregulta për mbrojtjen e diplomës, të cilat janë: (1) Java e 3të e Janarit (2) java e 3të e Korrikut. Ndërkaq studentët kanë të drejtë të mbrojnë diplomën edhe në Sezonin e Shtatorit.

<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 8.7 Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studentit duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.</li> <li>- 8.8 Të diplomuarit në këto programe studimi duhet të kenë punuar/konspektuar/trajtuar listën e botimeve të paraqitur individualisht në syllabuset e kurseve të ofruara.</li> </ul> <p>Ndërkohë rregullorja mbi “Punimin e Diplomës”, pika II, saktëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- II.1 Në fillim të vitit akademik, në tetor, çdo departament organizon një takim për të konsultuar tema të ndryshme, të cilat mund të shërbejnë si fushë studimi për tezën në nivel diplome si dhe për të identifikuar drejtuesit e mundshëm të tezave.</li> <li>- II.2 Çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së tretë të semestrit të parë, ofron propozime konkrete për temat e tezës, të cilat ai/ajo është i gatshëm t'i mbikëqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema.</li> <li>- II.3 Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga departamenti përkatës me formularin e aplikimit për tezën në të dy ciklet (BA) dhe (Master), së bashku me listën e drejtuesve të mundshëm të tezës dhe grupin e këtyre temave.</li> <li>- II.4 Studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një drejtues të mundshëm dhe e dorëzon atë brenda javës së tetë të semestrit të parë. Në rast të mospërmbushjes së afatit, studentit mbron tezën e tij në sezonin e ardhshëm.</li> </ul> <p><i>(Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca 13. Manual i Punimit te Tezes se Diplomes; Evidenca 10. Rregullore e Programit te Studimit MSc. ne Administrim Biznesi; Evidenca 12. RREGULLORE e Sekretarise cikli i dyte 2021-2022; Evidenca D6. Listat e temave qe kane zgjedhur studentet per te mbrojtur diplomen. MBA 2020-2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të aksesuar si dhe takimeve të zhvilluara në institucion GJV konstatoi se programi Master Shkencor në Administrim Biznes ka të miratuar diplomën dhe suplementin e diplomës përmes Urdhërit nr. 78 datë 13.05.2020 Prot. 1434/6 të MAS/ QSHA, dhe në përfundim të studimeve studentit pajiset me to. Gjithashtu studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	

<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	KU IKT ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Afatet e ruajtjes së tij përshkruhen dhe ndiqen sipas “Librit të Rregulloreve Institucionale”, Rregullore e Arkivit, fq. 112-116.  <i>(Evidenca 17. Urdher nr. 78, date 13.05.2020 miratimi i formes se diplomes programi MSc Admin Bizn + suplementi; Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht  <b>X</b>


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht  <b>X</b>
---	----------------	-----------------------	----------------------	---------------------------------------

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) ku specifikohet se informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ruhen në katër njësi të ndryshme. Të dhënat në lidhje me stafin akademik në njësinë e parë mblidhen dhe ruhen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Administrim Biznesit). Në njësinë e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësor, mblidhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit. Në njësinë e tretë, sekretarinë e Fakultetit, ku ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me procesin mësor, si: procesverbale, etj. Në njësinë e katërt, sistemin AMS të ASCAL, të dhënat hidhen prej Koordinatorit të Institucionit për çdo vit akademik. Gjatë vizitës në disa prej këtyre

	<p>zyrave u evidentua ruajtja në dosjet respektive të të dhënave të personelit akademik dhe administrativ.</p> <p><i>(Evidenca 7: Libri i Rregulloreve Institucionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që u bënë pjesë e DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Këto procedura paraqiten në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kërkohet staf akademik me gradën shkencore Doktor, pra një nivel më lart se niveli i studimeve, Master i Shkencave. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme sic u verifikua nga tabelat e të kërkuara dhe të dërguara nga IAL.</p> <p><i>(Evidenca "Politikat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik"<sup>5</sup>)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe dokumentat e paraqitura në evidencat 38, 39, 40 dhe 41 si edhe disa njoftimeve online për vend të lire, shpallur në faqen e KU "IKT": <a href="https://cit.edu.al/job-vacancy-faculty-of-economy-20-july/">https://cit.edu.al/job-vacancy-faculty-of-economy-20-july/</a> si edhe <a href="https://cit.edu.al/economy-vacancy-announcement/">https://cit.edu.al/economy-vacancy-announcement/</a>.</p> <p>GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik nuk kanë një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Pra, GVJ është e mendimit se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishin të rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe që do të garantonin rekrutimin e personelit akademik cilësor dhe si rrjedhim rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 7: Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VIII, Kreu I, "Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik/Politics and Procedures of Recruiting of Academic Staff"), fq. 140-143.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Sipas vlerësimit në RVB dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton praktikën e ndjekjes së procedurave të rekrutimit të personelit akademik, në përputhje me kriteret e bëra publike dhe sipas rregullores institucionale. Gjatë vizitës në IAL u kërkua nga BNJ të na vendoset në dispozicion një praktikë punësimi</p>

<sup>5</sup> Shiko në shtojcë: Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VIII, Kreu VIII, Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik, fq. 140-143.



strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	<p>për një PAK dhe një PAE gjatë këtyre 3 viteve të fundit. Procedurat e rekrutimit, sidomos ato të kohëve të fundit, ishin dokumentuar dhe plotësuar në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik në KU IKT. Komisioni i Rekrutimit përbëhet nga: Zv.Rektori, Drejtuesi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe sipas rastit pedagogë, si dhe ekspertë të fushave përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca 7: Libri i Rregulloreve Institucionale, Kapitulli VIII, Kreu I, "Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik/Politics and Procedures of Recruiting of Academic Staff"), fq. 143</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.2**  
**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe konstatoi se në dokumentat bazë (Plani Strategjik i Zhvillimit të KU IKT, Strategjia e Zhvillimit të Programit të Studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi), përmenden synime dhe objektiva të mirëfillta të Institucionit për përmirësimin e stafit akademik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se pavarësisht se KU IKT ka ndryshuar ambientet, mund të shprehim deri diku se lidhur me ambientet për stafin akademik të këtij programi studimi ishin të përshtatshme, duke ju mundësuar personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ kryerjen e detyrave të tyre në kushte normale, megjithëse ambientet ishin relativisht të vogla. Si GVJ konstatojmë se në RVB në disa kritere mungojnë analizat e përshtatshme sipas kriterit dhe fushave të kërkuara për vlerësim.</p> <p><i>(Evidenca "Strategjia e Zhvillimit të CIT", miratuar me Vendim Senati Akademik nr. 08.05.2017)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe evidencave (tabelat 19) mund të konstatojmë se kërkimi shkencor i stafit tregojnë se nuk janë ende në drejtimin e duhur për kryerjen dhe pjesëmarrjen në aktivitete kërkimore dhe bashkëpunime shkencore me vlerë. Sipas RVB, KU IKT është angazhuar që ta mbështesë kërkimin shkencor të stafit akademik duke u krijuar mundësi atyre për publikime falas në revistën shkencore institucionale, në sponsorizimin e publikimeve të tyre, si dhe në pjesëmarrjen falas në konferencat e</p>

	<p>organizuara prej institucionit, ashtu sikurse dhe në sponsorizimin për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare (Evidenca D1.3 dhe D1.4). Megjithatë, GVJ vlerëson se duhet bërë shumë më tepër në këtë drejtim, dhe gjatë vizitës në vend përfaqësues të KU IKT u shprehën për objektivat e tyre në rritjen e këtij angazhimi, dhe kjo ngelet për tu parë në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidenca nga Tabelat e RVB: Tabela 19 “Kërkimi shkencor i stafit akademik”; Evidenca D1.3 dhe D1.4.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe përfaqësues të IAL, GVJ konstatoi se Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe përdorimit të teknologjive të reja në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Një prej tyre është: Ëorkshop: Gamification in Education (Aplikimi i elementeve të lojës në edukim) datë 07.10.2021 si edhe Ëorkshop: Improve innovation ëith gamification (Përmirësimi i novacionit me gamifikim) datë 03.11.2021<sup>6</sup>.</p> <p>Të dhëna të tjera për këtë fushë nga GVB janë shkruar në në Standardin III.4, kriteret 3 dhe 5.</p> <p><i>(Evidenca “Strategjia e Zhvillimit të CIT 2017-2024”, miratuar me Vendim Senati Akademik nr. 08.05.2017, Prot. 11. fq. 16-18.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2) në evidencën “Të dhëna tabelore”) si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se stafi akademik, administrativ dhe drejtues kanë një angazhim optimal për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për ngarkesën në orë mësimore të kryer vetëm nga PAE me grada dhe tituj shkencor<sup>7</sup>. Fakulteti Ekonomisë në vitin aktual akademik ka 23 PAE dhe 0 PAK, ndër ata 7 nuk kanë ende gradë shkencore apo titull, ndërsa Departamenti Administrim Biznesit ka 8 PAE (të dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3


<sup>6</sup> <https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/>

<sup>7</sup> <https://cit.edu.al/faculty-of-economy-staff/>



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se ky program studimi zhvillohet në ndërtesat e marra me qera nga KU IKT në adresën Rr. Khanfize Keko, Kompleksi Xhura, nr.12, Tiranë. (Evidenca 32 dhe 33, “Planimetria” dhe “Kontrata e Qerasë”). Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (Tabela 16/1 dhe 16/2), GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohej kryesisht në oraret e pasdites dhe në funksion të këtij programi studimi është një sallë ku kryhen orët mësimore në auditor dhe bibliotekë përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj.</p> <p><i>(Evidenca 32 dhe 33, “Planimetria” dhe “Kontrata e Qerasë”; Tabela 16/1 dhe 16/2)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (Tabela 16), GVJ konstatoi se ambientet mësimore në KU IKT ishin të pajisura me videoprojektorë, lidhje interneti ëireless dhe kushte të tjera të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor. Bazuar në mësimin e zhvilluar gjatë vitit të fundit në platformat online, u konstatua se për këtë program studimi ishin shfrytëzuar G Suite e cila u vlerësua efektive në përdorim nga ana e studentëve.</p> <p><i>(Evidencë: Tabela 16)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka në dispozicion laboratorë informatike (Tabela 16/1 dhe 16/2) që mund të aksesohet në çdo moment gjatë gjithë javës nga ora 9:00 deri në 21:00. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas GVB, kapaciteti i sallave (klasave) ku zhvillohet mësimdhënia varion nga 30-35 studentë në ato me 50-60, dhe me 100-180 studentë. Gjithashtu, disa prej lëndëve/moduleve i japin një peshë të madhe punës në laborator pasi kërkojnë realizimin e projekteve nga ana e studentëve. Ata në çdo orë të ditës mund të shfrytëzojnë laboratorët si dhe programet e instaluar në këto laboratorë, për realizimin e projekteve dhe detyrave të caktuara. Kompjuterat në laboratore kanë të instaluar programet profesionale si: MS SQL Server; Microsoft Visual Studio; etj.</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB të përgatitur nga Institucioni citohen disa mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera aplikative praktike në bashkëpunim me biznese dhe institucione me të cilat KU IKT ka nënshkruar marrëveshje. Këto gjenden në dokumentacionin e dorëzuar në DVV, në tabelën 5. Aty GVJ gjen disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave nga ana e studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 47 "Informimi i Studentëve për mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e praktikav"; Evidenca "Manuali praktikës"; Evidencat D 7/1, 7/2, 7/3; Tabela 5.)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas verifikimeve të dokumentacionit (tabela 16 në RVB) të kryera nga GVJ, Institucioni raporton se ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë shumë të pasur, e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka virtuale, në sajë të marrëveshjes me McGraë-Hill Education<sup>8</sup>. Kjo sallë është në dispozicion të studentëve të këtij programi. Biblioteka ka një fond të pasur me libra në fushat e Ekonomisë, e pasuruar me tituj të ndryshëm, në saj të fushatave për blerjen dhe donacione. <i>(Tabela 16)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specififikës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas DVV të përgatitur nga Institucioni referohet se në Bibliotekat e Institucionit mund të gjenden fizikisht rreth 3000 tituj, me rreth 20 tituj në gjuhën shqipe dhe rreth 2780 tituj në anglisht dhe me një sektor të veçantë të gjuhës së huaj. Gjithashtu, KU IKT merr rregullisht numrat më të fundit të revistave dhe periodikëve dhe pasuron bibliotekën me to<sup>9</sup>.</p> <p>KU IKT ka krijuar kushte të përshtatshme për akses në bibliotekë on-line pa pagesë studentët. Atyre, ju janë prezantuar revista në të cilat biblioteka ka abonime dhe janë informuar për burime të tjera, që u janë vënë në dispozicion në faqen e internetit, siç janë librat me akses falas, bazat e të dhënave me akses të plotë dhe artikuj të tjerë të</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KU IKT ka krijuar kushte të përshtatshme për akses në bibliotekë on-line pa pagesë studentët. Atyre, ju janë prezantuar revista në të cilat biblioteka ka abonime dhe janë informuar për burime të tjera, që u janë vënë në dispozicion në faqen e internetit, siç janë librat me akses falas, bazat e të dhënave me akses të plotë dhe artikuj të tjerë të</p>

<sup>8</sup> <https://cit.edu.al/mcgraw-hill-literature/> (McGraw-Hill Education Textbook)

<sup>9</sup> <https://cit.edu.al/library-2/> (Library Policies/Rregullat e Bibliotekës)



	<p>rekomanduar nga profesorët. Për Bibliotekën Virtuale ka udhëzues<sup>10</sup> për përdorimin e bibliotekës online që ju janë prezantuar studentëve gjatë seminareve. Meqënëse në DVV nuk u gjetën dokumentacione bazë në lidhje me përmbajtjen e titujve në bibliotekë, gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi në vend, disa tituj në bibliotekë dhe GVJ sugjeron shtimin dhe zgjerimin e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në sallat e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim aksesit në Internet nëpërmjet rrjetit ëireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të KU IKT. Por nga ana tjetër në bibliotekë kishte rreth 25 poste nga të cilat vetëm 6 me kompjutera. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë. Sugjerojmë shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në DVV të përgatitur nga Institucioni, për këtë kriter deklarohet se IKT përmes marrëveshjeve me institucione të ndryshme prej vitesh ka shfrytëzuar teknikat dhe metodat e e-learning dhe e-reading duke pasur disa marrëveshje të frytshme për literaturën dhe përdorimin e saj si ajo me HVB (Harvard Business School dhe ajo me McGrawHill Education)<sup>11</sup> si edhe me Agjencinë e Abonimit<sup>12</sup> të Shtypit për sigurimin e periodikëve më të njohur ndërkombëtarë në fushën e ekonomisë dhe Kompaninë Distributor TEXO për shpërndarjen e teksteve në Shqipëri dhe në aksesin online të platformës O'REILLY. Meqënëse gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument që vërteton ekzistencën dhe për më tepër implementimin e një plani të detajuar të pasurimit të zërave të bibliotekës, ndaj sugjerohet hartimi i një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, duke pasur parasysh edhe sugjerimin më herët në këtë raport për përditësimin me literaturë të 5 viteve të fundit për disa prej lëndëve të programit.</p> <p><i>(Evidenca 43 "Te dhena mbështetese per blerjen e literatures ne biblioteken e IKT.pdf"; Evidenca 44 "Të dhënat...")</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të</p>	<p>Salla e Bibliotekës së KU IKT konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e saj koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin</p>

<sup>10</sup> <https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-partnership-with-mcgraw-hill-has-delivered-training-on-the-latest-updates-of-mcgraw-hill/>

<sup>11</sup> Marrëveshja me McGrawHill Education dhe Marrëveshja me HVB.

<sup>12</sup> Marrëveshja mes IKT dhe Agjencia e Abonimit të Shtypit, datë 15.09.2021 dhe Marrëveshja CIT-TEXO.

<p>procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>në këtë program studimi. Biblioteka kishte 6 poste pune me kompjuter, dhe rreth 25 poste pune në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret<sup>13</sup> e funksionimit të Bibliotekës ishin çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 08:00 – 21:00 dhe të Shtunën 08:00-15:00. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër studentësh që ndjekin këtë program studimi. Kjo u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në DVV se KU IKT ka në përdorim dhe shfrytëzon një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me gjeneralitetet dhe ecurinë e studentëve. Përmes “Sistemi Menaxhimit të Institucionit” apo të njohur ndryshe si “University Management System (UMS)” organizohen dhe administrohen të gjitha proceset mësimore, dhe një ndër ato është MSC në Administrim Biznesi. Sistemi është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritet) dhe ai akademik i KU IKT.</p> <p><i>(Evidenca D 5, D 5/1; D 5/2 “Raportet qe mund te gjeneroje sistemi per stafin dhe studentet nga UMS.pdf”</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sipas DVV, Sistemi i Menaxhimit të Institucionit (UMS) është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët dhe për aktivitetet e personelit akademik, me përjashtim të ndërveprimit mes institucionit dhe studentit e cila zhvillohet përmes komunikimit me e-mail, megjithatë studenti ka mundësi që me adresën e tij të përdorë Bibliotekën, literaturën mësimore dhe Classroomin Virtual, Sistemin e Menaxhimit, si dhe të aksesojë pyetësorët. Me anë të UMS sekretaria mësimore hedh online rezultatet e provimeve për studentët. Ndërkohë,</p>

<sup>13</sup> <https://cit.edu.al/library-2/> (Opening Hours/Orari i hapjes)

	<p>nëpërmjet filtrave të përdorur, sekretaritë mund të selektojnë studentët sipas programeve të caktuara, vitit akademik, qytetit, emrit, etj.</p> <p>Sistemi, në varësi të aksesit përdoret prej: stafit administrativ, sekretaritë e fakulteteve, studentët dhe stafi akademik. Secila kategori përdoruesish akseson vetëm panelin e vet, pa pasur qasje të tjera. Gjithashtu, kërkesës së GVJ për të depozituar një certifikim për sigurinë që ka UMS në ruajtjen e të dhënave, IAL u shpreh se do të na dërgonin një përgjigje pasi të konsultoheshin, por kjo nuk u dërgua as me dokumentat shtesë pas vizitës në IAL.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse referohet në DVV të përgatitur nga Institucioni dhe sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, nga ana e GVJ, nëpërmjet UMS studentët mund të aksesojnë online rezultatet për lëndët që ndjekin, si dhe të kontrollojnë informacione të tjera rreth tyre, etj. Çdo student mund të shikojë të dhënat personale të tij, por nuk ka akses në ndryshimin e rezultateve akademike., si edhe ju mungon moduli për manaxhimin e veprimeve financiare të studentëve. Për këtë të fundit po punohet ta adresojnë. Gjithashtu, UMS ka kufizime për secilin përdorues, sipas kategorisë, si edhe gjeneron dhe të dhëna mbi numrin e tyre, frekuentimet, programin ku janë regjistruar, notat, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të referuara në RVB, sistemi UMS<sup>14</sup> i KU IKT, nuk mundëson ndërveprimin brenda këtij sistemi mes aktorëve të institucionit. Pra, Sistemi i menaxhimit UMS përmes adresës zyrtare nga institucioni mund të aksesohet nga studentët, stafi përmes faqes së internetit të institucionit. Të drejtën për të aksesuar në këtë sistem e kanë të gjithë ata përdorues që janë të pajisur me një adresë zyrtare nga institucioni. Por, sistemi ka të integruar platforma si Google Classroom dhe module, që të mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. UMS nuk e kryen vet të gjitha brenda një sistemi, pra ky kriter nuk përmbushet plotësisht.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit UMS, është një sistem që mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimin nga ana e studentëve dhe e stafit. Gjithashtu, sistemi prodhon edhe disa raportime individuale, ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. <i>(Evidenca D 5, D 5/1; D 5/2 "Raportet qe mund te gjeneroje sistemi per stafin dhe studentet nga UMS..pdf"</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, personelin akademik të përfshirë në të, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimn e bursave të studimit dhe aktivitetet e ndryshme të KU IKT gjenden të pasqyruara në faqen e ëeb-it të KU IKT.</p>

<sup>14</sup><https://cit.edu.al/my-cit-2/>

paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacionet janë në ëëbsitë <sup>15</sup> të KU IKT vetëm në gjuhën angleze. GVJ rekomandon që informacionet në faqen e internetit të publikohen menjëherë edhe në gjuhën shqipe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorzuar në DVV, buxheti financiar i KU IKT hartohet nga Administratori i IAL-së bazuar në propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Bordi i Administrimit i KU IKT dhe është subjekt i auditimit të jashtëm, për të cilin ka edhe raport me opinion, për të cilin do të shprehem në kritere të tjera në vijim.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Informacioni i përfshirë në Raportin Vjetor të KU IKT për vitin akademik 2020-2021 (Evidenca 27, faqe 55 dhe 56) është shumë i përmbledhur në rang institucional dhe në asnjë moment nuk i referohet vetëm programit të studimit në fjalë. Vec kësaj, në asnjë nga këto evidenca nuk u gjetën informacione në lidhje me kostot specifike të programit të studimit; apo informacion për pasurimin e bibliotekës, etj.  Në përfundim, çështja qëndron që IAL nuk ka një raport financiar të kostove të programit të studimit MSC Administrim Biznesi dhe mbi të gjitha nuk ka një plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimit për të paktën një cikël të plotë studimi duke pasë parasysh edhe situatën financiare në të cilën ndodhet.  (Evidenca 46 “Raporti Auditit të Jashtëm për Institucionin; Evidenca 27 “Raportin Institucional Vjetor i KU “IKT” për vitin akademik 2020-2021”)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishtme financiare të të ardhurave nga tarifata e	Në RVB për këtë kriter, raportohet se pasqyrat financiare të Institucionit i nënshtrohen procesit të auditimit nga auditues ligjorë të pavarur dhe plotësohen të gjitha kërkesat e nevojshme.  Por, GVB nuk shprehet për atë çfarë kriteri kërkon cit: “Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit

<sup>15</sup> [www.cit.edu.al](http://www.cit.edu.al)

<p>shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme...”. Përsa kërkon ky kriter, GVB do të duhej të ishte shprehur duke e shoqëruar me evidenca nëse ekzistonte Auditimi Brendshëm në KU IKT dhe çfarë raportesh ka gjeneruar për drejtimin e KU IKT. Në përfundim, GVJ evidenton mungesën e Auditimit të Brendshëm pranë KU IKT, dhe si rrjedhim rekomandon ngritjen e kësaj strukture pranë KU IKT.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Për të analizuar shkallën e përmbushjes së këtij kriteri, GVJ u mbështet në analizën e RVB dhe tabelave mbështetëse të saj, si edhe dokumentacionit shoqërues, pjesë e DVV.</p> <p>Nga shqyrtimi i (<i>Evidencës 27, faqe 55 dhe 56</i>), GVJ evidenton se Institucioni ka paraqitur nja plan financiar institucional për vitin 2020-2021 dhe 2021-2022. Ky plan nuk përmban asnjë analizë për tre vitet e kaluara dhe nuk paraqet asnjë planifikim për ndërhyrjet e posaçme apo diversifikimin e financimit të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Elemente të tilla nuk i ndeshëm as në evidenca të tjera, pavarësisht se referuar Tabelës 18 tek shtojca e RVB paraqiten të dhënat e të ardhurave për tre vitet e fundit për të gjitha programet e IAL-së së bashku.</p> <p><i>GVJ rekomandon që IAL të përcaktoj njësinë përgjegjëse për plotësimin e analizave të viteve të kaluara dhe planifikimin për vitet e ardhshme lidhur me sigurimin e financimit të nevojshëm për këtë program studimi.</i></p> <p><i>(Evidenca 27 “Raportin Institucional Vjetor i KU “IKT” për vitin akademik 2020-2021”)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Në bazë të informacioneve financiare të dhëna në evidencën 46, GVJ konstaton se Institucioni vijon të jetë me humbje duke e rritur atë në disa qindra milion lekë. Megjithatë nga përfaqësues të IAL si edhe në evidencën 27, shprehen se IAL ka vijuar të mbështetet nga ortakët themelues të kësaj IAL-je. Por, mungon informacioni i plotë që të lejojë GVJ të formojë një opinion pozitiv në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të Institucionit. GVJ rekomandon të merren masat menjëherë nga KU “IKT” për lidhjen e kontratës së sigurimit me një prej shoqerive të sigurimit në Shqipëri për mbrojtjen e studentëve nga risku ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera (referuar Ligjit të Arsimit të Lartë si edhe Nenit 98, pika f. e Statutit të KU “IKT”)</p> <p><i>(Evidenca 46 “Raporti Auditit të Jashtëm për Institucionin; Evidenca 27 “Raportin Institucional Vjetor i KU “IKT” për vitin akademik 2020-2021”; Evidenca 1 dhe 1/1 “Statuti UKT 2016 dhe )</i></p>			
	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të RVB (Evidencat 1, 7, 8, 9, 10...), u konstatua se Institucioni ka hartuar politika dhe procedura të plota të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme të ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre në hyrje dhe në dalje, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin e tyre në përfundim të ciklit të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MAS.</p> <p>GVB për këtë standard ka bërë një analizë të shoqëruara plotësisht me evidencat respektive. Sipas RVB dhe verifikimit të bërë nga GVJ, rregulloret ishin të printuara për përdorim të përgjithshëm në bibliotekë nga studentët, si edhe një pjesë e këtyre dokumenteve dhe rregulloreve gjenden të publikuara në faqen e internetit të KU IKT<sup>16</sup>.</p> <p><i>(Evidenca 1 dhe 1/1 "Statuti KU IKT", Evidenca 7 "Libri rregulloreve institucionale" Evidenca 8 "Rregullore FE", Evidenca 9 "Rregullore Dep AB", Evidenca 10 "Rregullore programit Msc Administrim Biznes", ...)</i></p>

<sup>16</sup> <https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf>

<https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Staf-Students-Mobility-Manual.pdf>

<https://cit.edu.al/admissions-3/>

<https://cit.edu.al/cit-broschures/>

<https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Master-first-year-2021-2022.pdf>

<https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-freezing-studies.pdf>

<https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-resumption-of-studies.pdf>

<https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Request-for-Termination-of-studies.pdf>

[https://drive.google.com/drive/u/0/folders/0B4qUzITNtw0SkiXSVhNQVByNUk?resourcekey=0-ffGQRsLwzXs2\\_R-27Jj-3A](https://drive.google.com/drive/u/0/folders/0B4qUzITNtw0SkiXSVhNQVByNUk?resourcekey=0-ffGQRsLwzXs2_R-27Jj-3A); <https://cit.edu.al/admissions-3/>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me Zv. Dekanin, Përgjegjës të Departamentit, GVB dhe stafin akademik, GVJ u informua se KU IKT ka si mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar <i>diversitetin kulturor</i> dhe vlerat e Shqipërisë në drejtim të barazisë. Nga përgjigjet e marra prej studentëve gjatë vizitës në vend, kuptuam se IAL dhe në veçanti stafi akademik mundohet të jetë transparent me studentët, i paanshëm, dhe të përdorë parime e kritere si barazia, ndershmëria, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga verifikimi publikimit të dokumentacionit lidhur me pranimet e studentëve për programin MscAB, GVJ formoi bindjen se kriteret e pranimit, të përzgjedhjes dhe ecurisë së studentëve përgjatë programit të studimit janë transparente të publikuara edhe në faqen e internetit të KU IKT.</p> <p>Pranimi i studentëve në programin e studimit MScAB i nënshtrohet fillimisht ekuivalentimit të diplomës nga komisioni i ngritur nga Dekanati. Në këtë proces vlerësohen dosjet dhe vendoset për aplikantët. Kjo e verifikuar përmes një praktike (Evidencat D3) të depozituar në AMS. Kriter për mesataren nuk ka, pavarësisht se thuhet që preferohet mesatare mbi 7.5 për studimet e ciklit të parë. Përderisa është një program Master Shkencor, GVJ këshillon përfshirjen e një kriteri për mesataren dhe duhet të ketë një nivel të cilësisë në hyrje për kandidatët. Kjo gjithashtu do të garantonte një lloj barazie mes aplikantëve të ndryshëm përsa i përket nivelit akademik të tyre.</p> <p><i>(Evidenca D 3 "Rasti i pranimit të një studenti me profil inxhenieri në këtë program..pdf"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se KU IKT harton, miraton me Vendim Senati dhe publikon kriteret e regjistrimit të studentëve për vitin pasardhës sipas kërkesave të MAS.</p> <p>Pas miratimit ato publikohen zyrtarisht në link faqja e internetit të Institucionit<sup>17</sup>.</p> <p><i>(Evidenca D 3/1 "Kriteret e pranimit sipas Vendim Senati nr.1/1 datë 12.01.2021, "Miratimi i Kritereve të regjistrimit për programet e ciklit të parë dhe të dytë në KU IKT")</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>GVJ konfirmon se KU IKT publikon një sërë udhëzimesh në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Vec kësaj, nga bisedat me studentët u pranua se bëhej një punë e mirë nga administrata e KU IKT në këtë drejtim<sup>18</sup>.</p>

<sup>17</sup> <https://cit.edu.al/admissions-3/>

<sup>18</sup> <https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf>

përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	GVB gjithashtu citon se: “në mbështetje të informimit të publikut si dhe kandidatëve të mundshëm, Institucioni organizon herë pas here “Open Eëek” (Ditë të Hapura)...si edhe ...Institucioni merr pjesë edhe në panairt e studimit të organizuara prej MAS, ose në takimet në institucione apo kompani të ndryshme në vend, me synim informimin për mundësitë e studimit në IKT <sup>19</sup> . (Evidenca: <a href="https://cit.edu.al/open-ëeek-at-cit/">https://cit.edu.al/open-ëeek-at-cit/</a> )			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve, kriteret e pranimit, tarifat, bursat dhe pagesat e ndryshme, pezullimi i studimeve, ç’regjistrimi nga institucioni, pjesëmarrja në mësim dhe lajmërimi përpara përbushjes së limitit të mungesave, ndjekja e lëndëve sipas viteve akademike, vlerësimi sipas tabelës së miratuar, kur kalon dhe kur ngel në një lëndë të caktuar, të drejtat për t’u ankuar lidhur me notën ose vlerësimin, procedurat që duhet të ndjekë për ankimimin, provimi përfundimtar si dhe testime të tjera, përcaktohen në kuadrin rregullator (si: Statuti, Rregullorja Institucionale, Rregullorja e Programit të Studimit, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Dytë, Libri i Rregulloreve Institucionale) të KU IKT. Këto ju vihen në dispozicion studentëve përmes guidës së studentëve <sup>20</sup> dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me stafin akademik. Të gjitha këto informacione gjenden edhe në faqen online të KU IKT.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Në kuadrin rregullator të KU IKT për këtë program studimi përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të KU IKT në IAL të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhen nga Komisioni ad-hock i Njohjes dhe Ekuivalentimit që ngrihet për çdo vit akademik edhe për këtë program studimi sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore, Cikli i Dytë, pika 2, Pranimet në ciklin e dytë, fq. 2.

<sup>19</sup> <https://cit.edu.al/open-week-at-cit/>

<sup>20</sup> <https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf>



	<i>(Evidenca 7 “Libri i Rregulloreve Institucionale”, Vlerësimi i Studentit, fq. 53; Evidenca “Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Cikli i Dytë, pika 2, Pranimet në ciklin e dytë, fq. 2.”; ...)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregullore si edhe në syllabulls (vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimin sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit, referuar tabelës së vlerësimit në rregulloren “Vlerësimi i Studentit”) të cdo lënde. Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit MscAB ju bëhen të ditur studentëve përmes Guidës (pikat 2.4 Ndjekja e lëndës dhe tërheqja prej saj; 2.5 Vlerësimi dhe notat; 2.6 Testimi) si edhe takimeve informuese që në orët e para të mësimt<sup>21</sup> në KU IKT.</p> <p><i>(Evidenca 20. “Programet e lëndëve MscAB”, Evidenca Rregullore “Vlerësimi i Studentit”)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregullore dhe informacion paraprak për diplomimin studentët e këtij programi e marrin që në vitin e parë kur regjistrohen. Gjithashtu, në Guidën e Studentit, e cila gjendet në mënyrë të përhershme edhe online në faqen e internetit të KU IKT, në pikën 2.10 të saj “Diplomimi” studentëve u jepet informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomim si dhe për politikën e plagjarizmit, pronësisë intelektuale dhe mënyrat e citimit e referimit.</p> <p><i>(Evidenca 13: “Manuali i Punimit të Tezes së Diplomes shqip.pdf”; Evidencë ““Modeli i përcaktimit të temës së diplomës”)</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	<p>KU “IKT” zhvillojnë takime informuese në të gjithë Shqipërinë. Po kështu, materialet promovuese japin informacion të bollshëm për programet e studimit. Këto materiale shpërndahen tek studentët potencialë, por edhe tek të interesuarit e tjerë. Takime të ndryshme janë organizuar edhe në ambientet e institucionit ku janë ftuar nxënës nga shkolla të ndryshme në Javë të Hapura (Open Week) që të informohen për programet dhe mundësitë që u ofrohen pranë KU “IKT”. KU IKT në fillim të çdo viti akademik organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto informacione përcillen edhe përmes panairëve apo masmedias, si edhe përgatitjes së fletëpalosjeve dhe posterave për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Takime të ndryshme janë organizuar edhe në ambientet e institucionit ku janë ftuar nxënës nga shkolla të ndryshme në Javë të Hapura<sup>22</sup>. Njëkohësisht në Ditët e Informimit IKT mundohet</p>

<sup>21</sup> <https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/>

<sup>22</sup> <https://cit.edu.al/open-week-at-cit/>

	që në takimet që zhvillon në rrethe të ndryshme të vendit, t'u shpërndajë materiale të mjaftueshme për të njohur institucionit, programet dhe mënyrën e funksionimit se si mund të regjistrohen. Gjithashtu, KU IKT jep informacion në ëëbsitin e tij për studentët potencialë që mund të duan informacion për programin e studimit MscAB <sup>23</sup> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet broshurave <sup>24</sup> , komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit, në llogarinë individuale të Studentëve në UMS si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqet në faqen e internetit të KU IKT. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që javën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimit u bëhet i njohur programi i lëndës, por edhe një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. (Evidenca 7 "Libri i Rregulloreve Institucionale.pdf")
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni informon vazhdimisht studentët e këtij programi studimi mbi mundësitë e punësimit që si edhe mbështetjen e KU IKT për orientimin e tyre drejt tregut të punës. Këtë e bën përmes kontakteve të drejtëpërdrejta me studentët për shkak edhe të numrit të vogël të tyre (rreth 13 studentë në vitin e parë dhe të dytë të këtij programi). Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që KU IKT ka lidhur me institucione publike dhe biznese, si edhe zhvillimin e aktiviteteve me institucione të ndryshme apo kompani private. (Evidenca: Tabela 23 "Mbi punësimin e të diplomuarve në programin MscAB")
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Orari mësimor, plani mësimor përveç se online, afishohen edhe në ambjentet e KU IKT, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i	

<sup>23</sup> <https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-administration-2/>

<sup>24</sup> <https://cit.edu.al/cit-broschures/>

përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Gjithashtu, studentët njoftohen rregullisht përmes takimeve me strukturat drejtuese dhe koordinatorët e programeve si dhe përmes emailit. Njëkohësisht studentët në faqen zyrtare të KU IKT në kategorinë “Jeta Studentore” mund të gjejnë të përditësuar gjithë informacionet e nevojshme lidhur me zhvillimin e procesit mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	KU IKT ka sistemin UMS. Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi aksesojnë sistemin UMS përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit. Por, siç kemi shprehur edhe më sipër nuk i plotëson të gjitha shërbimet e nevojshme, megjithatë IAL kujdeset për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e UMS.			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Bazuar në RVB, përveç UMS duhen edhe Google Drive dhe Google Classroom për të mundësuar menaxhimin e informacionit për aktivitetin mësimor. Nga GVJ rekomandohet të investohet në pasjen e një sistemi të vetëm i cili duhet edhe të çertifikohet për cilësinë dhe sigurinë e funksionimit dhe eruajtjes së të dhënave ndër vite. Sipas GVJ: në sistemin UMS menaxhohet i gjithë informacioni që ka të bëjë me programet mësimore dhe programet e lëndëve, vlerësimin e studentëve, ndjekjen e progresit të tyre, sipas kalueshmërisë apo përsëritjes, etj; në Google Drive menaxhohet procesi i ruajtjes dhe shpërndarjes së informacionit prej stafit akademik dhe atij administrativ; në Google Classroom menaxhohet informacioni që ka të bëjë me procesin mësimor (me orën e mësimin). Gjithashtu, në sekretari <sup>25</sup> , në format hard copy dhe elektronik, ruhet i gjithë informacioni rreth procesit mësimor, frekuentimit, procesverbalet e lëndëve, kalueshmërisë, provimeve, tezave të diplomave, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<sup>25</sup> <https://cit.edu.al/academics-2/>; <https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-administration-2/>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>KU IKT mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik. Bazuar në të dhënat sipas tabelës 21, konstatojmë se:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2019-2020 ishte 17 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 7.1, si edhe nuk ka pasë asnjë student të transferuar;</li> <li>• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2020-2021 ishte 7 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 7.6, si edhe nuk ka pasë asnjë student të transferuar;</li> <li>• numrin e studentëve të regjistruar në vitin 2021-2022 ishte 6 studentë me notë mesatare në hyrje në nivelin 7.5, si edhe nuk ka pasë asnjë student të transferuar.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Në vitin akademik 2020-2021 rezulton një rritje e notës mesatare nga 7.1 në 7.6 (Tabela 21).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna mbahen në rregjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Sipas të dhënave në RVB, IAL organizon aktivitete të dedikuara për ALUMNI<sup>26</sup>, duke krijuar mundësinë e mbajtjes së kontaktit me ata si edhe marrjen e opinioneve të tyre në vijimësi, pasi eksperiencat dhe mendimet e tyre janë një vlerë e çmuar. Për këtë arsye propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të mirëpritura për përmirësime të programit për studentët pasardhës (Evidenca 19).</p> <p>Pavarsisht se IAL ka realizuar disa veprimtari me ALUMNI, ka përpunuar disa të dhëna analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje por jo në dalje të studentëve, si edhe nëse është i punësuar apo jo, GVJ evidenton se kaq nuk është e mjaftueshme për t'u konsideruar një raport mbi profilin e studentëve dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, dhe për më tepër që aty mungojnë masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Si rrjedhim, kërkohet të rritet vëmendja e zyrave respektive në</p>

<sup>26</sup><https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-cit-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-credins-invest/>; <https://cit.edu.al/highlights-of-financa-5-training-for-cit-alumni/>; <https://cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/>; <https://cit.edu.al/monthly-students-forum-challenges-and-opportunities-of-the-entrepreneurship-in-albania/>

	<p>këtë drejtim me qëllim që në përfundim të vitit akademik strukturat përgjegjëse të prodhojnë raporte të azhuruara dhe të plota për punësimin e rrejtës ALUMNI në profilin e programit të studimit apo jashtë profilit, si edhe nevojat e tyre. Disa statistika përfshihen edhe në raportin vjetor të IAL-së Evidenca 27, “Raporti Vjetor Institucional i KU IKT”, fq. 42-48.</p> <p>Gjatë vizitës në Sekretari Mësimore u kërkua të prezantohen nëse të dhënat e studenteve mbahen në 3 regjistra siç shprehet Neni 100, pika 1 e Statutit të KU IKT. Gjithashtu u kërkua nëse ato janë të arkivuara në Arkivën e Shtetit pasi është detyrim, dhe të mbahen në IAL vetëm kopje e Njehësuar me Origjinalin e tyre. Nga Sekretaria na u prezantuan ato fizikisht, pasi i kishin ende gjendje në IAL.</p> <p>Në përfundim, sjellim në vëmendje të IAL: Të tre regjistrat e mesipërm është detyrim të jenë edhe elektronik, të përcaktohet me procedurë se kush e ka detyrimin të plotësojë, si edhe të sigurohet ruajtja e tyre në kushte të përshtatshme.</p> <p><i>(Evidenca 27 “Raporti Institucional...”, Evidenca 77 “Gjurmimi...”, Evidenca 19 “Vlerësimi i Programeve të Studimit dhe studimi për tregun e punës pas daljes së studenteve, fq. 100-118.”)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e KU IKT, IAL duhet të angazhojë studentë dhe/ose përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të tij. Sipas RVB-së, studentët në KU IKT bazuar në ndryshimet statutores të vitit 2019 janë të organizuar zyrtarisht në një përfaqësim prej 3 studentësh në Senatën e kësaj IAL-je.</p> <p>Gjithashtu, studentët janë pjesë e Këshillave të Fakulteteve, Këshillit të Etikës, NJSBC, Komitetit të Bursave, Komiteteve dhe Komisioneve të tjera, siç parashikojnë edhe rregulloret përkatëse në Librin e Rregulloreve Institucionale (Evidenca 7 nga faqe 12 deri në faqe 33).</p> <p><i>(Evidenca 1 Statuti i KU IKT.pdf. Evidenca 7 “Libri Rregulloreve.”)</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter evidentohet “Student Life” (Jeta Studentore), e cila është një hapësirë që shfrytëzohet për të reklamuar punën që studentët bëjnë me CIT E-Neësletter<sup>27</sup>, për mundësitë e mobiliteteve studentore, për Qeverinë Studentore, etj.</p> <p>Gjithashtu, në RVB evidentohet qartë garantimi dhe përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në struktura vendimmarrëse, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, por nuk faktohet me evidenca konkrete dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme kjo përfshirje dhe cilat janë kontributet e tyre. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët e MscAB, GVJ kërkoi prej tyre të identifikonin disa prej rezultateve të kontributit të përfaqësuesve të tyre në këto organizma, por edhe ata nuk ishin në gjendje të jepnin evidenca apo raste konkrete lidhur me sa më sipër.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se ky program studimi është i mirë hartuar në drejtim të mbajtjes në konsideratë të ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Ngarkesa totale e orëve në auditor për të dy vitet akademike është 1210 orë, e shpërndarë në 605 në vitin e parë dhe 605 në vitin e dytë. Gjithashtu, referuar kuadrit rregullator të KU IKT nuk evidentohen procedura burokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme në përputhje me kriteret ligjore në RSH. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve për studentët e transferuar bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Kurrikulës.</p> <p><i>(Evidenca 10. “Rregullore e Programit të studimit MScAB”. Evidenca 12. “RREGULLORE e Sekretarise cikli i dYTE 2021-2022.pdf”, Evidenca 7 ““Libri i Rregulloreve Institucionale”, Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, fq. 33-35”, Evidenca 14. ““Manuali i stafit akademik”, Komiteti i Kurrikulës, fq. 31-32)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në këtë IAL, përmes pyetjeve të kryqëzuara për drejtuesit e UK IKT, arritëm të kuptojmë se ata përpiquan të alikojnë disa metoda për përfshirjen me qëllim tërheqjen e mendimit të studentëve lidhur me procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përmes formularëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve.</li> <li>• takimeve të drejtëpërdrejta me studentët apo përfaqësues të tyre</li> <li>• përmes studentëve si përfaqësues në Senat.</li> <li>• përmes studentit si përfaqësues në NJSBC.</li> </ul> <p>GVJ gjatë vizitës kërkoi nga NJSBC disa raste konkrete të ilustruara për çfarë është marrë në konsideratë mendimi i studentëve të këtij programi</p>

<sup>27</sup> <https://cit.edu.al/student/>

	<p>Studimi. Nuk kishte përgjigje për tu evidentuar, ndoshta studentët nuk kanë pasë asnjë pretendim apo sugjerim për përmirësim. Pavarsisht se vetë ata gjatë vizitës në institucion u shprehën për kohën e gjatë për të marrë përgjigjet e provimeve, mos pasjen e financimit për kërkim shkencor apo përfaqësim në konferenca ndërkombëtare, etj.</p> <p>GVJ bazuar në këto përgjigje kupton se kjo njësi nuk arrin të marrë mendimin e lirë të studentëve të cilët janë pretendentët kryesorë në këtë veprimtari. GVJ rekomandon KU IKT-së të merren masa që NJSBC të gjejë dhe krijojë çdo hapësirë të mundëshme për tërheqjen e opinionit të studentëve me qëllim rritjen e cilësisë së këtij programi mësimor.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Bazuar në disa evidenca të paraqitura në AMS evidentohet se studentëve të këtij programi ju mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë si edhe e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve.</p> <p>Sipas GVB, në rast se studenti ka ankesë për vlerësimin (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar,...), pasi e ka konsumuar këtë me pedagogun e lëndës ajo/ai mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai e bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani (kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit) ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar.</p> <p><i>(Evidenca 1.1 "Statuti i KU IKT", Evidenca 10. "Rregullore e Programit të studimit MScAB", Evidenca 7 "Libri i Rregulloreve Institucionale", "Mbi Vlerësimin e Studentit" (Student Evaluation), fq. 53-56", Evidenca 12 "Rregullore e Sekretarisë Mësimore Cikli i Dytë", pika 5.6, Kërkesa për rivlerësim dhe ankimimet e ndryshme, fq. 6-7").</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b></p>	
<p><b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete</p>	<p>GVJ vlerëson me konsideratë të lartë pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi, si edhe pjesëmarrjen e e</p>



<p>ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>spikatur të një pjese prej tyre në angazhime publike me impakt në ekonominë dhe jetën e vendit, por edheangazhimin e tyre në projekte dhe kërkim shkencor me bashkëpunëtor kombëtar dhe ndërkombëtar. GVJ nuk evidentoi skema motivuese financiare nga IAL për këtë kategori të stafit akademik.</p> <p>Sipas GVB, prej vitit 2016 e deri më sot janë organizuar 14 konferenca prej KU IKT, ndërsa 12 nga ato janë bashkëpunime të Fakultetit të Ekonomisë. Një përmbledhje<sup>28</sup> e këtyre koferencave gjendet edhe në faqen e internetit të institucionit: <a href="https://cit.edu.al/research-2/">https://cit.edu.al/research-2/</a> Punimet e stafit akademik, apo të studentëve publikohen pa tarifë në “CIT Revieë Journal”, apo proceedings të konferencave.</p> <p>Sipas GVB, prej vitit 2016 e deri më sot janë organizuar 14 konferenca prej KU IKT, ndërsa 12 nga ato janë bashkëpunime të Fakultetit të Ekonomisë . Gjithashtu, punimet e stafit akademik, apo të studentëve të KU IKT publikohen<sup>29</sup> pa pagesë në “CIT Revieë Journal”, apo proceedings të konferencave, por në funksion të kërkesave për grada shkencore dhe tituj sipas VKM Nr.112 datë 23.02.2018 dhe ndryshimit me VKM-Nr.808 datë 11.12.2019, kërkohet mbështetja e pjesëmarrjes së stafeve akademike në konferenca ndërkombëtare të organizuara në vendet e OECD-së dhe publikime në revista të indeksuara me SCOPUS apo JCR dhe me faktor impakti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>GVJ evidenton angazhime në drejtim të lidhjes nga KU IKT të marrëveshjeve me institucione të huaja të arsimit të lartë, kryesisht në fushën e projekteve ERASMUS+ për mobilitet stafi dhe studentësh.</p> <p>KU IKT ka nënshkruar edhe disa marrëveshje të tjera mirëkuptimi me universitete për organizim konferencash, shkëmbim stafi dhe aktivitete të përbashkëta si edhe bashkëpunimi në kuadër të aplikimit dhe zbatimit të projekteve. Por, në këto marrëveshje nuk gjendet e evidentuar nëse ky program studimi që po vlerësojmë ka ndonjë përfitim.</p> <p><i>(Evidenca: Tabela 17-21. “Marreveshjet ERASMUS+”, Tabelat 8-11 “Projekte të fituara prej IKT”)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Sipas RVB, vlen të përmendet se Fakulteti Ekonomisë ka organizuar disa konferenca studentore në bashkëpunim edhe me IAL të tjera në vend apo organizata të specializuara të fushës. Por, për këtë kriter, GVB nuk ka evidentuar referenca lidhur me studentët e programit të studimit MscAB, por të dhëna në Tabelën 23 janë në nivel institucional, dhe asnjë prej studentëve nuk i përket programit të studimit MscAB.</p>

<sup>28</sup> <https://cit.edu.al/research-2/>

<sup>29</sup> <https://crj.cit.edu.al/all-journals/>



	<i>(Evidenca: Tabela 23 "Punime shkencore të stafit në bashkëpunim me studentët,,)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Referuar të dhënave në tabelën 22 "Punimet shkencore të stafit akademik" nuk ka të dhëna nëse shifrat i përkasin stafit akademik të programit të studimit MscAB. Gjithashtu, edhe ato që janë referuar si publikime i përkasin "CIT Revieë Jouran".  GVJ, gjen përsëri me vend të evidentoj se në funksion të kërkesave për grada shkencore dhe tituj sipas VKM Nr.112 datë 23.02.2018 dhe ndryshimit me VKM-Nr.808 datë 11.12.2019, kërkohet mbështetja e pjesëmarrjes së stafeve akademike në konferenca ndërkombëtare të organizuara në vendet e OECD-së dhe publikime në revista të indeksuara me SCOPUS apo JCR dhe me faktor impakti.  <i>(Evidenca: Tabela 22. "Punimet shkencore të stafit akademik")</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Referuar RVB, KU IKT ka investuar në krijimin e kushteve për mbështetjen e ideve dhe përpjekjeve studentore duke organizuar disa aktivitete nxitëse si dhe për këtë qëllim është themeluar edhe CIT HUB, si një qendër krijuese për promovimin e inovacionit dhe sipërmarrjes. Por, përsëri GVJ evidenton se në referencat e cituara në DVV nuk u konstatua përfshirja e drejtëpërdrejtë e studentëve të programit MscAB.			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Bazuar në Evidencën 13. "Manual i Punimit te Tezes se Diplomes.pdf,, për këtë program Studimi janë përcaktuar qartë hapat që duhet të ndiqen nga studenti si edhe udhëheqësi. Nga diskutimi me studentët gjatë vizitës në IAL konstatoam se kishin nisur punën në bashkëpunim me stafin akademik udhëheqës për evidentimin e metodologjisë që do të përzgjidhnin në funksion të temës së punimit të diplomës.  <i>(Evidenca 13. "Manual i Punimit te Tezes se Diplomes.pdf,,)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi V.7

**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen	Bazuar në RVB, evidentohet se KU IKT ka lidhur rreth 16 marrëveshje Erasmus të nënshkuara me universitete prej shtetesh si: Spanja, Gjermania, Polonia, Portugalia, Franca, Finlanda, Letonia, Austria, Çekia, Bullgaria e Turqia. Gjithashtu, KU IKT si pjesë e CEEPUS ka një

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 73

e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	<p>mobilitete me shtete si: Sllovenia, Sllovakia, Hungaria, Maqedonia, Serbia, Polonia dhe Rumania. Pra, KU IKT përmes këtyre marrëveshjeve ka rritur aktivitetet dhe mobilitetet e stafit dhe studentëve në nivel institucional, por përsëri asgjë e evidentuar posaçërisht për këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidenca: Tabela 20 "Të dhëna për bashkëpunime në rang fakulteti/programi studimi")</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Referuar DVV dhe RVB nuk gjenden argumenta dhe evidenca të drejtëpërdrejta për plotësim e këtij kriteri, si rrjedhim GVJ e konsideron jo të përmbushur si kriter.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	<p>Për këtë kriter GVJ nuk gjeti referenca relevante në RVB, pasi GVB nuk ka evidentuar referenca lidhur me studentët e programit të studimit MscAB të përfshirë në projekte kërkimore. Sipas Tabelës 23 studentët janë në nivel institucional, dhe asnjë prej studentëve nuk i përket programit të studimit MscAB.</p> <p><i>(Tabela 23 "Punime shkencore të stafit në bashkëpunim me studentët,,)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	<p>Në RVB konstatohet se KU IKT mirëpret partneritete në projekte të përbashkëta, lektorë të huaj të ftuar për të pasuruar programet mesimore dhe teknikat e mësimdhënies. Duke qenë se KU IKT është një institucion që ofron programe në gjuhën angleze, integrimi i stafit të huaj në institucion është një proces i natyrshëm.</p> <p>KU IKT ndër vite ka punësuar staf të huaj akademik me prejardhje nga shtete të ndryshme, të tilla si: Kanadaja, Britania, Spanja, etj. Lidhjet e tyre me institucionet akademike në vendet ku ata vijnë, kanë shërbyer si ura ndërlidhëse për të organizuar konferenca ndërkombëtare si dhe për të zhvilluar kërkimin shkencor. Megjithatë, GVJ nuk konstaton staf akademik të huaj në programin MscAB. <i>(Evidenca: Raporti Vlerësimit të Brendshëm)</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	<p>Referuar RVB, Institucioni ndjek një politikë të hapur të mbështetjes së mobiliteteve duke krijuar lehtësira për studentët që aplikojnë. Gjithashtu, GVB ka dhënë argumenta dhe evidenca për këtë kriter se ku bazohet politika favorizuese e KU IKT për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p> <p><i>(Evidencat 14 "Manuali i Stafit Akademik Tetor 2021.pdf"; Evidenca 15 "Manuali i Keshillimit të Karrieres.pdf")</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe	KU IKT ndër vite ka punësuar staf të huaj akademik me prejardhje nga shtete të ndryshme, të tilla si: Kanadaja, Britania, Spanja, etj. Lidhjet e tyre me institucionet akademike në vendet ku ata vijnë, kanë shërbyer si



mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	<p>ura ndërlidhëse për të organizuar konferenca ndërkombëtare si dhe për të zhvilluar kërkimin shkencor. Gjithashtu sipas GVB, vetëm në vitet e fundit janë organizuar 25 leksione të hapura dhe seminare<sup>30</sup> me lektorë të huaj, si edhe janë mbajtur leksione të hapura në kuadër të mobiliteteve Erasmus dhe CEEPUS nga rreth 16 pedagogë nga institucionet partnere.</p> <p>(Evidenca: Raporti Vlerësimit të Brendshëm; <a href="https://cit.edu.al/neesletters/">https://cit.edu.al/neesletters/</a>)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Null përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.8

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>GVJ evidenton se në KU IKT ka një njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe ajo quhet Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve &amp; Këshillimin e Karrierës. Nga kjo zyrë studentëve ju jepet informacion i plotë mbi çdo gjë që ka të bëjë me licencimin e programeve, mundësitë e karrierës dhe punësimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, njohjen e krediteve etj. Po ashtu zyra ruan lidhje të ngushta me Qeverinë Studentore dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, pas përfundimit të studimeve prej tyre, kjo zyrë ndjek dhe ecurinë e punësimit dhe zhvillimit të tyre të karrierës, si edhe përgatit të dhëna statistikore dhe i prezanton ato për analiza të mëtejshme<sup>31</sup>.</p> <p>Referuar RVB-së, KU IKT disponon sistemin UMS si edhe google platform të cilat ndihmojnë në mbajtjen e komunikimit dhe informimit të studentëve.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL u pyetën studentët se kush kujdeset për kërkesat e tyre dhe ata u shprehën se kryesisht gjenin mbështetje tek vet stafi akademik, drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, si edhe nëse do të ishte e nevojshme edhe tek strukturat e tjera në dispozicion.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	

<sup>30</sup> <https://cit.edu.al/newsletters/>

<sup>31</sup> <https://cit.edu.al/student/> ; <https://cit.edu.al/alumni>

<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	GVJ duke konsideruar numrin shumë të pakët të studentëve në këtë program studimi, vlerëson se kërkesat e studentëve përse kërkohet në këto kritere të standardit V.8, arrijnë të adreson mirë.  (Evidenca: Raporti Vlerësimit të Brendshëm ; <a href="https://cit.edu.al/student/">https://cit.edu.al/student/</a> ; <a href="https://cit.edu.al/alumni">https://cit.edu.al/alumni</a> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe komunikimit me drejtues të IAL gjatë vizitës në IAL, konstatojmë se KU IKT në zbatim të detyrimit të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 që prej vitit 2013 ka ngritur strukturën e NJSBC referuar Nenit 28 dhe 29 të Statutit të KU IKT. Pra, në këtë IAL pretendohet të kemi një njësi me eksperiencë dhe praktika pune të konsoliduara. Ndër vite NJSBC ka punuar për hartimin e politikave dhe rregulloreve që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e NJSBC-së. Ato janë: -Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; -Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit; -Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit; si edhe dokumenti kryesor (përveç atyre që citohen në statutin e KU IKT) që është “Manuali i NJSBC”.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes	NJSBC përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore (një për secilën njësi), 1 (një) personel i administratës, 1 (një) përfaqësues i studentëve dhe 1 (një)


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 76



<p>proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>ekspert i jashtëm që drejton njësinë. Anëtarët e Njesisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, me mandat 4 vjeçar.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Referuar DVV-së, në tabelat 25, 26, 27 dhe 28 evidentojmë se kemi mungesë përfaqësimi të administratës sipas parashikimit në statutin e KU IKT për të pasë në NJSBC një përfaqësues të administratës.</p>			
	<p>Sipas Nenit 28 të Statutit të KU IKT, Drejtuesi NJSBC duhet të jetë ekspert i jashtëm dhe të ketë mandat 4 vjeçar. Ndërkohë që sipas komunikimit me drejtuesin e NJSBC kuptuam se ai ishte staf administrativ në KU IKT. GVJ rekomandon, të ndryshohet kjo pikë e statutit ose të ndryshohet marrëdhënia e punësimit me drejtuesin e NJSBC.</p>			
	<p>Në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit Senati Akademik i KU IKT ka miratuar “Manualin e Sigurimit të Cilësisë” (QAU Handbook), si edhe Planin strategjik të zhvillimit të KU IKT ku shprehet edhe rritja e cilësisë e cila duhet të shërbejë si busull orientimi për NJSBC në punën e saj për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>			
	<p>Nga GVB por edhe në takimet gjatë vizitës në IAL, u evidentua se Dekani, përgjegjësi i departamentit, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat si dhe përfaqësues të NJSBC takohen për të diskutuar rishikimin e mësimdhënies dhe të nxëniet dhe performancën e secilit program të lidhur me fakultetin. GVJ vlerëson si praktikë të mirë diskutimin e hapur për përmirësimin e cilësisë për këtë program studimi.</p>			
	<p>Gjithashtu, sipas RVB dhe tabelës nr. 29, që prej vitit 2014 e në vazhdim NJSBC në fund të çdo semestri në nivel institucional ka zhvilluar rreth 22 pyetësorë për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut të lëndës, si edhe 2 anketime për të parë nivelin e punësimit prej studentëve ALUMNI. Të dhënat e përpunuara janë raportuar pranë Rektorit, Senatit Akademik dhe Dekanateve. Pretendohet se ato kanë shërbyer për krijimin e kulturës së cilësisë në rang njësie dhe institucioni.</p>			
	<p><i>(Evidenca 1.1 “Statuti i KU IKT”; Evidenca 7 “Libri rregulloreve institucionale” Kreu II, “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit” fq. 28-32; Evidenca 11 “Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf”; Evidenca 2 “Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017.pdf; Evidenca 19 “Vlerësimi i prgramit të studimit në përputhje me objektivat dhe Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit dhe Fakultetit...pdf”; Tabelat 25,26,27,28, 29).</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	KU IKT bazuar në Vendimin e Senatit Akademik, nr. 07, datë 24.09.2021, pika 15 ka krijuar Komisionin e Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat në përbërje të të cilit janë 7 pedagogë me grada shkencore si edhe një studente. Pjesë e detyrave të këtij komisioni është edhe puna në shërbim të monitorimit, shqyrtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Bazuar në “Librin e Rregulloreve institucionale”, fq. 33, Komisioni i Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat mandaton Komitetin e Programit të Kurrikulës për të kryer procesin e vlerësimit bazuar në një planifikim periodik. Anëtarët e Komitetit të Programit të Kurrikulës zgjidhen nga Komisioni i Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat. Ata mund të jenë anëtarë të Komisionit të Përhershëm ose të zgjedhur nga stafi akademik i çdo programi studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Sipas GVB, në KU IKT kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik realizohet nëpërmjet vlerësimit të çdo pedagogu dhe lënde nga vetë studentët; vetëvlerësimit të performancës nga çdo pedagog; vlerësimit prej drejtuesve të departamenteve dhe vlerësimit “administrativ” për aspekte të tilla si respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimi, respektimi i afateve, korrektesa e çdo pedagogu në plotësimin e dokumentacionit përkatës, etj. Në përfundim të kontrollit të programeve të studimit, hartohet raporti i programit i cili firmoset prej përgjegjësit të departamentit, komitetit të programit dhe vlerësuesit të jashtëm si edhe një anëtari të NJSBC <sup>32</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në përgjigje të kriterit 4, nga GVB kemi të formuluar se NJSBC përmes pyetësoreve online përmes Google Forms, vlerëson prej studentëve në fund të çdo viti akademik programet e lëndëve për pothuajse 90% të atyre që zhvillohen atë semestër. Vlerësimi është lidhur me komponentët e mësimdhënies, programit të lëndës, metodologjinë e përdorur, etikën e pedagogut, etj. Të dhënat përpunohen prej NJSBC dhe në formën e raporteve ju dërgohen Rektorit, Senatit Akademik dhe Dekanëve, si edhe çdo pedagogu përmes adresës së emailit i dërgohet në formë të përmbledhur pikët e grumbulluara.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	

<sup>32</sup> “Vlerësim nga njësia kryesore dhe eksperti i jashtëm për programin MSc në Administrim Biznesi.”

GVJ konstatoi se nuk përfshihej Drejtuesi Departamentit i cili përfaqëson kreun e njësisë bazë dhe duhet të përfshihet menjëherë sapo dalin rezultatet me qëllim diskutimin e tyre me çdo pedagog dhe marrjen e masave për adresimin e gjetjeve. GVJ, sjell në vëmendje të NJSBC dhe Senatit Akademik të merren masat për përfshirjen e drejtuesit të njësisë bazë dhe konkretisht atij të Departamentit të Administim Biznesit.

Bazuar në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar gjen si praktikë të mirë aplikimin në KU IKT të teknikës së vetvlerësimit<sup>33</sup> të stafit akademik. Gjithashtu, nga një shkallë më sipër në strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente për secilin pjesëtar të stafit bazuar në këtë format vetvlerësimi. Pavarësisht këtyre, në evidencat e dorëzuara në DVV, nuk është kthyer përgjigje Kriterit 5, i cili kërkon masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.

Në përfundim, GVJ rekomandon:

- NJSBC të mbajë evidenca për të reflektuar ndjekjen e plotësisë të rekomandimeve të dhëna nga raportet e posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.
- Senati Akademik dhe Bordi Administrimit të KU IKT të kërkojnë një analizë (folloë up) të zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga raportet për përmirësimin në vijim të cilësisë.
- IAL të marrë masat për përfshirjen menjëherë sapo dalin rezultatet të drejtuesit të njësisë bazë (Departamentit të Administim Biznesit) me qëllim diskutimin e tyre me çdo pedagog dhe marrjen e masave për adresimin e gjetjeve.
- Meqënëse drejtuesit e KU IKT synojnë të jenë transparent me studentët, stafin si dhe të gjitha palët e interesuara duhet të publikojnë raporte më të plota të vlerësimit të studentëve në uebsite të KU IKT.

*(Evidenca 1.1 "Statuti i KU IKT"; Evidenca 7 "Libri rregulloreve institucionale" Kreu II, "Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit" fq. 28-32; Evidenca 11 "Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook.pdf"; Evidenca "Vendimi i Senatit Akademik, nr. 07, datë 24.09.2021"; Evidenca "Vlerësim nga njësi kryesore dhe eksperti i jashtëm për programin MSc në Administrim Biznesi"; Evidenca "Raportet e Vetvlerësimit" të stafit akademik 2020-2021").*

<sup>33</sup> "Raportet e Vetvlerësimit" të stafit akademik 2020-2021

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>KU IKT ka përgjegjësinë t'i ofrojë shoqërisë shqiptare një cilësi të lartë të programeve mësimore, të tregojë se po bën përpjekjet e duhura për të përdorur në mënyrë efektive dhe efikase tarifat e studimit nga studentët e tij, kapitalin aksioner, etj., dhe të sigurojë mbarëvajtjen cilësore të këtij programi studimi jo vetëm deri në diplomimin e studentëve por edhe daljen e tyre në tregun e punës apo sigurimin e trajnimit të vijueshëm të tyre edhe pas diplomimit.</p> <p>Sipas RVB-së, metodat e përdorura prej KU IKT janë ato të përmendura në standardin VI.2, të cilat ndahen në: metoda të drejtpërdrejta dhe ato tërthore të përcaktuara edhe në rregulloret përkatëse si dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së KU IKT. Më konkretisht, instrumentet e përdorura përfshijnë nga pyetësorët e anketimet, deri tek angazhimi i vlerësuesve të jashtëm për vlerësimin e programeve të studimit.</p> <p>Duke qënë se në RVB nuk shprehet që KU IKT organizon takime dhe diskutime me punëdhënësit, gjatë vizitës në IAL u pyet NJSBC lidhur me këtë. Ata u shprehën se kryejnë, por nuk kanë depozituar evidenca, të cilat mund të tregojnë çfarë mendimesh kanë marr dhe si i kanë adresuar ato. Takimet dhe diskutimet me punëdhënësit janë nga më të rëndësishmet pasi ata përmes tyre mund të kuptohen nevojat e tregut të punës dhe nevojat për përmirësim të këtij programi me qëllim punësimin në profesionin/fushën e tyre të studentëve të programit MScAB.</p> <p>Në përfundim, GVJ i këshillon IAL-së që përveç metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që aplikon duhet të përdorë edhe metoda dhe instrumenta të tjera të cilat ndihmojnë vlerësimin dhe ndërtimin e qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit, të tilla si sondazhe e intervista me punëdhënësit për studentët e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të</p>	






studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar RVB, KU IKT nuk ka asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit ose studentëve. Përkundrazi institucioni i ka përfshirë studentët në të gjitha instancat kolegjiale dhe vendimmarrëse, së bashku me stafin akademik. Siç e kemi cituar edhe më sipër, KU IKT në procesin e vlerësimit, Fakulteti i Ekonomisë ka përfshirë edhe aktorë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, në nivel eksperti të jashtëm për programin e studimit MScAB është vlerësuar prej Prof.As.Dr. Gj. Sh. si ekspert i jashtëm <sup>34</sup> . Por, në fakt në evidenca të tjera, figurojnë Prof. Asoc.Dr. E.M apo Dr. E.C si ekspertë të jashtëm për këtë program studimi. Për GVJ kjo ka krijuar konfuzion për saktësinë se Kush dhe Si e ka kryer në fakt rolin e ekspertit të jashtëm për këtë program studimi, si edhe cila është procedura dhe bazuar në çfarë kriteresh ata përzgjidhen.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e	Gjatë vizitës në IAL, për pyetjen e GVJ se: Çfarë teknikash përdor IAL për marrjen e opinionit të pretendentëve/stakeholders të këtij programi studimi? Përgjigja ishte organizim takimesh me bizneset për marrjen e mendimit të tyre, si edhe vlerësim nga eksperti i jashtëm për çdo 2-3 vjet. Edhe sipas GVB, evidentojmë një praktikë të veçantë në KU IKT e cila i

<sup>34</sup> "Vlerësim nga njësia kryesore dhe eksperti i jashtëm për programin MSc në Administrim Biznesi."



administrativ dhe studentët e programit të studimit.	referohet vetëm vitit 2020 se institucioni ka angazhuar ekspertë të jashtëm që në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulave kanë vlerësuar programet e studimit në KU IKT. Sipas RVB, ekspertët e jashtëm kanë kontribuar duke analizuar përputhjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut, ecurinë e studentëve në këto programe studimi, stafin e angazhuar në mësimdhënie, tregun e punës, etj. Vlerësimi i tyre ka ndihmuar për të kuptuar performancën e programit të studimit me të gjithë komponentët e tij. Një vlerësim i tillë është bërë edhe për programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi sipas evidencës 19 “Vlerësim nga njësia kryesore dhe eksperti i jashtëm për programin MSc në Administrim Biznesi”. Por GVJ nuk ju dhanë cilat ishin rezultatet konkrete se çfarë gjetjesh janë evidentuar dhe se çfarë përmirësimesh cilësore janë reflektuar në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjithashtu, GVJ evidenton se:			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Statuti KU IKT në nenin 90, pika 3 përcakton se vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet për çdo 6 vjet, ndërkohë që duhet të ndryshohet kjo pikë e statutit pasi ky është afati maksimal që mund të marr me vendim të Bordit të ASCAL. Në fakt afatet mund të jenë të ndryshme nga 0 vjet deri në 6 vjet maksimalisht. Pra në këtë pikë të statutit duhet të shtohet “...të paktën për çdo 6 vjet” që do të thotë se vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet në vijimësi sipas riskut të vlerësuar, sepse standardet e monitorimit të cilësisë janë në përfaqje të metodologjisë me bazë riskun dhe jo me cikël. Në nenin 106 të ligjit të arsimit të lartë citohet: “Vlefshmëria e çdo akreditimi institucional dhe e programeve të studimit që lidhen me të nuk mund të zgjasë më shumë se 6 vjet”, duke shprehur një tavan të sipërm për numrin e viteve maksimale të mundshme për akreditim nga bordi i ASCAL por aspak për t’u aplikuar kjo si tregues nga strukturat brenda IAL-së të cilat kanë detyrë dhe përgjegjësi për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.  <i>(Evidenca 1.1 “Statuti i KU IKT”; Evidenca 7 “Libri rregullorëve institucionale” Kreu II, “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit” fq. 28-32; Evidenca 11 “Manuali i Sigurimit të Cilesisë - QAU Handbook.pdf”; Evidenca “Vlerësim nga njësia kryesore dhe eksperti i jashtëm për programin MSc në Administrim Biznesi”).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>	

### Standardi VI.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 82

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se për këto kriteret nuk ka përgjigje të drejtpërdrejta dhe konkrete të shoqëruar me evidenca.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Një tjetër kërkesë e një kriteri në këtë standard është për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, ndërsa në RVB shprehet për publikimin nga KU IKT të të dhënave për NJSBC-në, manualët, si dhe vlerësime që kanë të bëjnë me gjithë programet e institucionit.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	KU IKT synon të jetë transparent me studentët, stafin si dhe të gjitha palët e interesuara si dhe të publikojë vlerësimin e studentëve për këtë proces. Por, nëse të dhënat nga pyetësorët konsistojnë vetëm në katër grafikë <sup>35</sup> që janë dhënë në dokumentin bashkëlidhur për programin MScAB, atëherë këto në mendimin tone si GVJ nuk janë të mjaftueshme për tu konsideruar se Institucioni i arsimit të lartë ka publikuar rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në përfundim, GVJ i sugjeron IAL-së, të merren masat për: <ul style="list-style-type: none"> <li>publikim të rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> </ul>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<sup>35</sup> <https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetsorit-2020-2021-1.pdf>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Praktika e mirë e ndjekjes së procedurave të rekrutimit të personelit akademik, skema e kompensimit, dhe vlerësimit në vijim të tyre në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator;
2. Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, dhe përdorimit të teknologjive të reja në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
3. Biblioteka virtuale ka një fond të pasur me libra në fushat e Ekonomisë, e pasuruar me tituj të ndryshëm, në saj të marrëveshjes me McGraw-Hill Education, si edhe aplikimi i teknikave dhe metodave të e-learning dhe e-reading bazuar në marrëveshjet me HVB (Harvard Business School dhe ajo me McGrawHill Education), etj;
4. Institucioni ka hartuar politika dhe procedura të plota të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e nevojshme të ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre në hyrje dhe në dalje, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin e tyre në përfundim të ciklit të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, udhëzimet e MAS dhe statutin e KU IKT;
5. KU IKT informon vazhdimisht studentët e këtij programi studimi përmes kontakteve online dhe të drejtëpërdrejta për çdo informacion të ri, apo informacion për të cilën ata kanë nevojë lidhur me procesin arsimor, social, apo për çdo mundësi punësimi dhe këshillimi për orientimin e tyre drejt tregut të punës;
6. Pjesëmarrje e spikatur e një pjese të stafit akademik në angazhime publike me impakt në ekonominë dhe jetën e vendit, por edhe angazhimin e tyre në projekte dhe kërkim shkencor me bashkëpunëtor kombëtar dhe ndërkombëtar;
7. Institucioni ofron mësimdhënien në gjuhën angleze, e cila lehtëson në aksesimin e një literature moderne në gjuhën angleze dhe favorizon mobilitin e stafit dhe të studentëve;

**b. Pika të dobta:**

1. Mungon analiza për planifikim financiar në planet financiare institucionale për 3 vitet e marra në analizë për ndërhyrjet e posacme apo diversifikimin e financimit të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij;
2. IAL nuk ka Auditim të Brendshëm;
3. Mungesa e botimeve shkencore në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, të stafit akademik të cilët janë kandidatë për fitimin e gradave shkencore apo titujve akademik;

4. Mungesë e një lëndë për përgatitjen metodologjike të studentëve, lëndë bazë e kategorisë A dhe e domosdoshme për studentë të masterit shkencor;


### **Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që informacionet në faqen e internetit të publikohen menjëherë edhe në gjuhën shqipe;
2. IAL të përcaktojë njësinë përgjegjëse për plotësimin e analizave për planifikim financiar lidhur me sigurimin e financimit të nevojshëm për të paktën një cikël të plotë studimi;
3. IAL të ngrrejë strukturën e Auditimit të Brendshëm;
4. Pavarsisht se mungon udhëzimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, IAL këshillohet të shikoj mundësinë e lidhjes së kontratës së sigurimit me një prej shoqërive të sigurimit në Shqipëri për mbrojtjen e studentëve nga risku i ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera (referuar Ligjit të Arsimit të Lartë si edhe Nenit 98, pika f. e Statutit të KU "IKT");
5. IAL të zbatoj nenin Nenin 28 të Statutit të KU IKT ose të ndryshojë dhe miratojë këtë pikë të statutit lidhur me marrëdhënien e punësimit të IAL me drejtuesin e NJSBC;
6. Senati Akademik i KU IKT të kërkojë me frekuencë të paktën 6-mujore ndjekjen (follow up) e zbatimit të detyrave apo masave për adresimin e gjetjeve, mangësive dhe rekomandimeve të evidentuara nga vendimet e Bordit të Akreditimit për përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit;
7. Institucioni të iniciojë mekanizma nxitës për stafin për të botuar artikuj shkencorë në revista prestigjioze ndërkombëtare të indeksuara në databazat Scopus apo Web of Science, botime të cilat janë një domosdoshmëri për fitimin e titujve akademikë;
8. Departamenti (Njësia bazë) duhet të bëjë rregullimet e duhura në kurrikul në mënyrë që studentëve t'iu ofrohen njohuri për metodat e kërkimit përmes një lënde të kategorisë A;

### **Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Business Administration"**

#### **a. Strengths and Affirmations:**

1. The good practice of following academic personnel recruitment procedures, the compensation scheme, and their subsequent evaluation in accordance with the legal and regulatory framework;
2. The institution constantly organizes activities within the further professional qualification of academic staff, for the improvement of teaching methods, and the use of new technologies in the teaching and learning process;
3. The virtual library has a rich inventory of books in the fields of Economics, enriched with various titles, as part of the agreement with McGraw-Hill Education, as well as the application of e-learning and e-reading techniques and methods based on agreements with HVB (Harvard Business School and the one with McGrawHill Education), etc;



4. The institution has developed comprehensive policies and procedures that cover all necessary aspects of the study cycle, starting with the entry criteria of students, their incoming and outgoing transfers, transition from one year to another, and graduation theirs at the end of the cycle of studies. The general and specific criteria have been drawn up in accordance with the requirements of Law No. 80/2015, MAS instructions and KU IKT statute;
5. KU IKT constantly informs the students of this study program through online and direct contacts about any new information, or information they need regarding the educational, social process, or about any employment opportunities and counseling for their orientation towards labor market;
6. Prominent participation of a part of the academic staff in public engagements with impact on the economy and life of the country, but also their engagement in projects with national or international collaborators;
7. The institution offers teaching in the English language, which facilitates access to a modern literature in the English language and favors the mobility of staff and students;

**b. Weak points:**

1. There is no analysis for financial planning in the institutional financial plans for the 3 years taken into analysis for special interventions or diversification of the financing of the Master of Science in Business Administration study program to guarantee its normal progress and functioning;
2. HEI has no Internal Audit;
3. Lack of scientific publications in prestigious international journals indexed in Scopus or Web of Science databases, of academic staff who are candidates for obtaining scientific degrees or academic titles;
4. Absence of a course for the methodological preparation of students, basic course of category A and necessary for students of the scientific master;

**Recommendation**

1. GVJ recommends that the information on the KU IKT website to be immediately published in the Albanian language as well;
2. HEI to determine the unit responsible for completing the analysis for financial planning related to securing the necessary funding for at least one full study cycle;
3. HEI to set up the Internal Audit structure;
4. Despite the lack of guidance from the Ministry of Education and Sports, HEIs are advised to look into the possibility of concluding an insurance contract with one of the insurance companies in Albania for the protection of students from the risk of interruption of activity or other risks (referred to the Law on of Higher Education as well as Article 98, point p. of the Statute of KU "IKT");
5. HEI to implement Article 28 of the Statute of KU IKT or to amend and approve this point of the statute regarding the employment relationship of HEI with the Head of IQAU;

6. The Academic Senate of KU IKT to request with a frequency of at least 6 months the follow-up of the implementation of tasks or measures for addressing the findings, deficiencies and recommendations evidenced by the decisions of the Accreditation Board for the further improvement of the quality of their study programs;
7. The institution should initiate incentive mechanisms for its staff to publish scientific articles in prestigious international journals indexed by Scopus or Web of Science databases;
8. The Department (Basic Unit) has to make appropriate adjustments in the curriculum adding an A category subject related to research methods, which will provide knowledge about the research methodologies to students of this Master of Science program;

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

